



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

DEPARTAMENTI I POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT RURAL/AUTORITETI MENAXHUES
Divizioni i Monitorimit, Vlerësimit dhe Raportimit

RAPORTI VJETOR (2024)

I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË SBZHR 2022 -2028

Prishtinë, 2025

Tabela e përmbajtjes

1	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3
2	TREGUESIT SOCIO-EKONOMIK DHE SEKTORIAL.....	5
2.1	TREGUESIT SOCIO-EKONOMIK	5
2.2	TREGUESIT SEKTORIAL.....	7
3	PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE.....	9
3.1	PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT	9
3.1.1	Objekti strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës	9
3.1.2	Objekti Strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore	14
3.1.3	Objekti Strategjik 3: Mbështetje për bizneset në zonat rurale, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës sociale.....	16
3.1.4	Objekti Strategjik 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike.....	19
4	VLERËSIMI I ARRITJEVE KRYESORE	22
4.1	Histori suksesi.....	22
5	VLERËSIMIN E SFIDAVE, MANGËSIVE DHE PENGESAVE	26
6	RESURSET BUXHETORE.....	26
7	KONKLuzionet dhe Rekomandimet për Hapat e Ardhshëm.....	26
8	RREZIQET dhe Hapat për Adresimin e tyre.....	28
9	SHTOJCA I: MATRICA E RAPORTIMIT (2024) PER ZBATIMIN E PV. (SBZHR: 2022-2830).....	30
10	SHTOJCA II: VLERESIMI I IDNIKATOREVE TE ZBATIMIT (2024)TE SBZHR: 2022-2830).....	44
11	REFERENCAT.....	47

Lista e tabelave

Tabela 1	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore, në '000 €.....	6
Tabela 2	Buxheti i MBPZHR, sipas kategorive për vitin 2024	8
Tabela 3	Pagesat direkte për sektorin e bujqësisë 2024 (Shuma/€ dhe Siperfaqe/kg).....	9
Tabela 4	Pagesat direkte për sektorin e blegtorisë 2024 (Shuma/€ dhe Krerë/kg)	10
Tabela 5	Zbatimi i objektivit specifik 1.1 (Buxheti i planifikuar/i shpenzuar/€)	11
Tabela 6	Buxheti miratuar dhe numri i aplikacioneve për masën 1	12
Tabela 7	Buxheti miratuar dhe numri i aplikacioneve për masën 3	12
Tabela 8	Zbatimi i objektivit specifik 1.2 (Buxheti i planifikuar/i miratuar/€).....	14
Tabela 9	Zbatimi i objektivit specifik 2.1 (Buxheti i planifikuar/i miratuar-shpenzua/€)	15
Tabela 10	Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve/Nënmasat	16
Tabela 11	Projektet sipas lotëve (Vlera e mbështetjes/€, shkalla e përkrahjes/%).....	16
Tabela 12	Buxheti miratuar dhe numri i aplikacioneve për Masën 5: LEADER	17
Tabela 13	Zbatimi i objektivit specifik 3.1 (Buxheti i planifikuar/i miratuar/€).....	17
Tabela 14	Zbatimi i objektivit specifik 3.2 (Buxheti i planifikuar/i shpenzua/€)	18

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028 pasqyron nevojën për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale, për të konkurruar në tregjet e Bashkimit Evropian dhe tregjet rajonale.

Identifikon masat/veprimet për rritjen e efikasitetit të prodhimit, përpunimit dhe marketingut bujqësor; ndërtimin e institucioneve të duhura, efektive publike dhe private; për të përmirësuar të ardhurat e fermave; për të siguruar që konsumatorët të kenë qasje në ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm; për të optimizuar përdorimin e burimeve të tokës, pyjeve dhe ujit, në mënyrë të qëndrueshme dhe miqësore me ambientin dhe për të ndërtuar komunitete rurale të qëndrueshme përmes zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Sipas analizave të përmbledhura, janë identifikuar objektivat strategjike dhe specifike, të cilat janë:

OS 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës	<i>O. specifik 1.1: Mbështetje të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe elasticiteti për të rritur sigurinë ushqimore</i> <i>O. specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave të tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe dixhitalizim</i> <i>O. specifik 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës</i>
OS 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokat, pyjet dhe uji)	<i>O. specifik 2.1: Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen me ndryshimet klimatike, si përdorimin e energjisë së ripërtëritshme</i> <i>O. specifik 2.2 Mbështetje në nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të tokës, ujit dhe</i> <i>O. specifik 2.3 Mbështetje në mbrojtjen e bio-diversitetit, shërbimet e zgjeruara të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve</i>
OS 3: Zhvillimi i bizneseve në zonat rurale, rritja e punësimit dhe përmirësimin i infrastrukturës sociale	<i>O. specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, përfshirë bio-ekonominë dhe zhvillimi i qëndrueshme i pylltarisë</i> <i>O. specifik 3.2: Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve</i> <i>O. specifik 3.4: Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cënueshme</i>
OS 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase	<i>O. Specifik 4.1 Riorganizimi dhe funksionalizimi i plotë i AZHB-së si Agjenci IPARD</i> <i>O. Specifik 4.2 Arritja e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masat e programi IPARD III</i> <i>O. Specifik horizontal 4.3: Dixhitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive</i>

Zbatimi i SBZHR-së 2022-28 bëhet nga dy lloje të masave të politikës: Shtylla I (pagesa direkte/subvencionet), Shtylla II (grante - zhvillimi rural), të ngjashme me Politikën e Përbashkëta Bujqësore (PPB) të BE-së dhe nga projekte kapitale ose infrastrukturore si dhe reformat institucionale që synojnë të funksionalizojnë më tej Ministrinë drejt një administrate publike më efikase.

Masat/Veprimet e identifikuar për të arritur përmbushjen e objektivave strategjike dhe specifike trajtojnë çështje të sigurimit dhe sigurisë së ushqimit, përmirësimin e të ushqyerit dhe promovimin e bujqësisë së qëndrueshme, ruajtjen e resurseve natyrore, barazisë gjinore gjithëpërfshirëse, punësim të plotë dhe produktiv dhe promovimin e mirëqenies, përfshirë edhe çështjet socio-ekonomike të zonave rurale.

Komiteti Monitorues në bashkëpunim me DPZHR-në (e cila vepron si sekretari), në baza vjetore monitoron progresin e zbatimit të SKBZHR 2022-23, deri me tani janë përgatitur dhe janë publikuar raportet e monitorimit për vitin: 2022 dhe 2023.

Sa i përket këtij raporti, të tret, i cili i referohet vitit paraprak, është përgatitur mbi bazën e matricës së planit të veprimit, e cila është pjesë e strategjisë. Raporti mbulon vitin kalendarik (2024), dhe ofron të dhëna për progresin e arritur në zbatimin e prioritetëve dhe masave/veprimeve në lidhje me arritjen e objektivave të strategjike.

Qëllimi i këtij raporti është të përshkruaj ecurinë e zbatimit të strategjisë, përmes indikatorëve matës të monitorimit. Në këtë raport, janë shfrytëzuar tregues të ndryshëm të performancës: Treguesit e aktiviteteve, ku janë përshkruar aktivitetet e strategjisë, baza ligjore, aktivitetet që i referohen procedurave të ndërlidhura me procesin e zbatimit, pastaj janë prezantuar indikatorët financiar (inputet): buxheti i miratuar/shpenzuar. Më pastaj indikatorët e outputeve: Numri projekteve/fermerëve aplikues/përfitues. Numri i fermerëve të cilët kanë marrë këshilla/trajnime, ndërsa përmes indikatorëve të rezultateve janë paraqitur sipërfaqet ekzistuese dhe të reja bujqësore/krerëve blegtoral të mbështetur përmes subvencioneve dhe granteve dhe sipërfaqet pyjore të ngritura përmes investimeve kapitale, sipërfaqet e rregulluara të kanaleve të ujitjes, etj.

Të dhënat e monitoruara/vlerësuara në raport janë marrë nga publikimet e AZHB-së, (DMPZHR, DK dhe PZHR 2024). Ndërsa të dhënat për indikatorët socio-ekonomik, i referohen publikimeve statistikore të ASK-së. Gjatë prezantimit të këtyre indikatorëve në disa raste kemi hasur në mungesë të të dhënave për vitin raportues 2024, në këto raste ju kemi referuar të dhënave të viteve paraprake.

Pjesë integrale e raportit është matrica e raportimit, në të cilat janë të prezantuara:

1. Objektivat/Veprimet
2. Afati i fundit
3. Buxheti (€) i Planifikuar/ Shpenzuar: 2024
4. Burimi i financimit
5. Përgjegjësitë për raportim
6. Produkti/Outputi
7. Referent;
8. Progresi i zbatimit, dhe
9. Treguesit e ndikimit të vlerësimi të zbatimit të SBZHR 2022-28.

2. Treguesit socio ekonomik dhe sektorial¹

2.1 Treguesit socio ekonomik

Sektori i bujqësisë ka luajtur dhe vazhdon të luaj një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit tonë, dhe duke pasur parasysh situatën me krizat e fundit globale, është vërejtur se bujqësia ka një rol kyç dhe është e ndërlidhur me secilën hallkë të sistemit të zhvillimit ekonomik.

Bujqësia mbetet një sektor kyç për ekonominë rurale. Ky sektor ka një ndikim të konsiderueshëm në punësim, me rreth 23% të të punësuarve dhe përfaqëson 7.2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (BPV).

Në një situatë kur sipërfaqet e tokës bujqësore janë të vogla dhe të fragmentuara, fokusi është vendosur në promovimin e kulturave me profitabilitet të lartë dhe treg të sigurt, si frutat, perimet dhe produktet organike. Ky lloj orientimi ka për qëllim diversifikimin e burimeve të të ardhurave për fermerët dhe ndihmon në përballimin e rreziqeve ekonomike që mund të lindin nga varësia nga produkte të vetme.

Pavarësisht përpjekjeve për të mbështetur sektorin, qasja në financimin bankar për bujqësinë mbetet shumë e ulët. Sipas të dhënave të vitit 2023, vetëm 2.1% e kredive totale janë dhënë për sektorin e bujqësisë. Nga ana tjetër, Institucionet Mikrofinanciare kanë pasur një performancë më të mirë, duke përbërë 17.2% të agrokredive të dhëna gjatë këtij viti. Nga viti 2019 deri në 2023, janë dhënë më shumë se 98,000 kredi, për një vlerë totale prej 508.2 mil.€, ndërsa afati dhe norma e interesit ndryshojnë në varësi të kushteve të kredisë.

Të dhënat e fundit tregojnë se shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në Kosovë është 40.7% apo 477,350 persona janë aktiv në tregun e punës, ndërsa 10.9% është shkalla e papunësisë apo 51,851 persona janë të papunë. Ndërsa, nëse i referohemi shkallës së punësimit të dhënat tregojnë se 36.6% apo 425,499 persona janë të punësuar gjithsej, ndërsa 59.3% e popullsisë në moshë pune është joaktive.

Të dhënat gjinore në tregun e punës tregojnë dallime të mëdha, nga e gjithë popullsia në moshë pune të punësuar 36.3%, meshkujt llogariten 53.4% të punësuar, krahasuar me femrat që llogariten 19.8% po ashtu të punësuar, gjithashtu edhe papunësia është dukshëm më e lartë tek femrat se sa tek meshkujt.

Në vitin 2024, kemi një rritje të ndërmarrjeve të regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkim (470) krahasur me vitin 2023 ku ishin 19% më pak (395),

¹ ASK dhe MBPZHR/DAESB'


Bilanci tregtar i produkteve bujqësore vazhdon të jetë negativ edhe në vitin 2023. Vlera e bilancit tregtar në vitin 2023 ishte rreth 1.1 mld. €, ndërsa shkalla e mbulueshmërisë së importit me eksport, në vitin 2023 paraqitet në shkallë prej 11.5%.

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore gjatë periudhës (2019-2023) ka shënuar rritje ndër vite. Në vitin 2023 vlera e eksportit të produkteve bujqësore ishte 148.0 mil. €, që paraqet rritje prej 24.8%.

Sa i përket shkëmbimit tregtar të produkteve bujqësore me vendet e tjera, Kosova ka eksportuar produkte bujqësore në vlerë prej 148 mil. € në vitin 2023, që shënon një rritje prej 24.8% krahasuar me vitin paraprak. Në të njëjtën periudhë, importi ka arritur në 1,285 mil. €, duke sjellë një bilanc tregtar negativ prej 1,137.0 mil. €, me një rritje prej 5.5% krahasuar me vitin 2022. Mbulueshmëria e eksportit me import është 11.5%, Pjesëmarrja e importit të produkteve bujqësore (01-24) në importin e përgjithshëm (01-98) në vitin 2023 ishte 21.7%, që paraqet shkallë të ngjashme të pjesëmarrjes me vitin paraprak, ndërsa viti 2020 ishte viti me pjesëmarrjen më të lartë të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm me 23.2%.

Marrë pasqyruar sfidat e mëdha që ka sektori për të arritur një bilanc tregtar pozitiv. Rritja e eksportit dhe importit të produkteve bujqësore në Kosovë gjatë 2023 është rezultat i një kombinimi faktorësh ekonomikë, politikash tregtare të favorshme, mbështetje për fermerët dhe investime në infrastrukturë dhe teknologji. Megjithatë, përballë këtyre arritjeve.

Tabela 1: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore, në '000 €



Viti	Eksporti (1-24)
	1
2019	65,510
2020	78,076
2021	92,642
2022	118,949
2023	147,993

Burimi: ASK, përpunuar nga MBPZhR-DAESB

2.2 Treguesit sektorial

Nëse i referohemi sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore për vitin 2023, sipas të dhënave të raportuara nga ASK ishte 420,688 ha krahasuar me vitin 2022 (420,482 ha) është me e lart, nga ku pjesa më e madhe prej 51.58% përbëhet nga kategoria livadhe dhe kullota, pasuar nga toka e punueshme me përqindje prej 44.79%, si dhe përqindja prej 3.63% apo 15,273 ha që janë: kopshtet, plantacionet e pemëve, vreshtave dhe fidanishtet.

Fondi i gjedheve në vitin 2023 ishte 247,493 krerë e që kishte rënie për 3,406 krerë në krahasim me vitin 2022.

Në vitin 2023 numri i dhenëve është rritur për 1.5% (3,013 krerë) në krahasim me vitin 2022, pas rënies së vazhdueshme të shënuar në 2 vitet e fundit Në vitin 2023 ka vazhduar trendi rënës i numrit të dhive që është paraqitur në vitin 2022.

Fondi i derrave (43,686 krer) ka pësuar rënie në dy vitet e fundit, pas rënies prej 4.1% në vitin 2022

Në vitin 2023, numri i përgjithshëm i shpezëve (2,997,000) shënoi rritje për 14.6% në krahasim me vitin 2022. Nga gjithsej numri i shpezëve 96% janë pula, 3% janë biba dhe 1% shpezë të tjera.

Sektori i bletarisë në vitin 2023 shënoi rritje prej 6.5% në numrin e koshereve (208,878) krahasuar me vitin 2022, përderisa në dy vitet paraprake pësoi ulje të vazhdueshme.

Prodhimet bimore dhe blegtorale kanë ndryshuar nga vitit në vit. Në aspektin e përgjithshëm nëse shikohet në 5 vjeçarin e fundit vërejmë se prodhimet bimore nga viti 2019 kanë shënuar rritje çdo vit, ndërsa në vitin 2023 vlera e gjithsej prodhimeve bimore shënon 578 mil.€, e që krahasuar me vitin 2022, që shënon rënie për 11.7%. Kjo rënie vjen si pasojë e rënies së vlerës së prodhimit të drithërave, bimëve foragjere, perimeve dhe prodhimeve të kopshtit.

Sa i përket pjesëmarrjes së kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, referuar të dhënave në figurën e mëposhtme themi se gjatë vitit 2023 kjo pjesëmarrje është si në vijim: kategoria e perimeve dhe prodhimeve të kopshtit (24.1%), pemët (23.3%), drithërat (22.1%), bimët foragjere (20.8%), patatet (9.1%), pasuar me kategoritë tjera si prodhimet tjera bimore (0.5%) dhe bimët industriale (0.02%).

Prodhimet blegtorale në periudhën 2019-2023, kanë shënuar trend rritje të vazhdueshme përpos vitit 2021, mirëpo në vitin 2023 vlera e gjithsej prodhimeve blegtorale shënoj 376 mil.€ apo 19.3% krahasuar me vitin 2022, kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së vlerës së produkteve blegtorale.

Sa i përket investimeve kapitale për rehabilitimin, modernizimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe te kullimit/drenazhit janë shpenzuar 4,240,031.44 €, është bërë rehabilitimi i sistemit të ujitjes për 7,750 ha sipërfaqe nën ujitje. Projekti do të vazhdon me një investim shtesë prej 10 mil €, kjo do të mundësoj rritjen e sipërfaqeve nën ujitje ne 11,000 hektarë,

ka pasur edhe investime tjera në digjitalizim dhe ngritje te kapaciteteve institucionale si dhe aktivitete te rregullta te ministrisë te cilat kontribuojnë ne progresin e zbatimit te Strategjisë.

Projektet e perfunduara: 1.Projekti i Ujitjes në Junik është përfunduar. 2. Projekti i Ujitjes në Deçan është përfunduar. 3. Projekti i Ujitjes në Klinë është përfunduar. 4. Projekti i Ujitjes në Mitrovicë

është marrë vendim për prerje të projektit për shkak të problemeve në teren ka mbetur projekti-kontrata pa përfunduar. 5. Projekti i Ujitjes ne Vushtrri është përfunduar. 6. Projekti i Ujitjes ne Istog është marrë vendimi për ndërprerje të kontratës për shkak të problemeve në teren (Komuna e Istogut nuk ka arritur t'i zgjidhe problemet). 7.Projekti i Ujitjes në Kamenice është ndërprerë kontrata për shkak të mos-përshtatjes së Dizajnit me kontratën-paramasën. 8. Projekti i Ujitjes në Shtime është përfunduar.

Gjatë vitit 2023, raportimet e Drejtorive Komunale të Bujqësisë nga komunat e Republikës së Kosovës dhe si dhe nga Ndërmarrjet Publike të Ujitjes janë raportuar se janë ujitur gjithsej 18,050 ha tokë bujqësore.

Sa i përket buxhetit të ndarë për zbatimin e planit të veprimit, i referohet buxhetit të ndarë bazuar në KASH: 2024-2027, përfshirë edhe buxhetin shtesë kryesisht për subvencione.

Tabela 2 Buxheti i MBPZHR, sipas kategorive për vitin 2024

Kategoritë	Buxheti i alokuar/€	Buxheti i shpenzuar/€	% e buxhetit të shpenzuar
Paga dhe mëditje	5,996,613.00	5,996,613.00	100%
Mallra dhe shërbime	6,787,395.00	5,888,652.00	86.77%
Shpenzimet komunale	156,461.00	131,728.00	84.19%
Subvencione dhe grante	81,597,022.00	81,221,473.00	99.54%
Projekte kapitale	1,038,332.00	685,851.00	66.05%
Gjithsej	95,575,823.00	93,924,317.00	98.27%

Burimi: MFP&T.

Për dallimi nga viti 2023, në vitin 2024 kemi një rritje të theksuar të buxhetit për subvencione dhe grante, për 15.68%.

3 PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

3.1 PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT

3.1.1 Objektivi strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës

Objektivi specifik 1.1: Mbështetje për të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe fleksibiliteti për të rritur sigurinë ushqimore

Për të rritur sigurinë ushqimore dhe qëndrueshmërinë e fermës janë ndërmarrë këto aktivitete:

Veprimi 1.1.1 - Kompensimi i dëmeve në bujqësi të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në 24 komuna të Kosovës

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në vitin 2023, si rezultat i kompensimit të dëmeve janë kompensuar dëmet në vlerë prej 1,368,855.68 €.

Veprimi 1.1.2 - Subvencionimi i skemës së sigurimeve bujqësore (Kultura bujqësore dhe kafshë)

Përgjatë vitit 2024, skema e sigurimit në bujqësi (kultura bujqësore), është bartur në PZHR, ashtu siç e parasheh Ligji për bujqësi dhe Zhvillim Rural (Nr.08/L-072). Buxheti i ndarë për këtë masë në vitin 2024 kap shumën: 200,000 euro, Në dispozicion janë dymbëdhjetë (12) produkte/kultura të cilat mund të sigurohen nga rreziqe të ndryshme: Produktet/Kulturat e përfshira në sigurime janë: Mollën, Rrushin, Kumbullën, Specin, Dredhëzën, Mjadrën, Arrën, Vishnjën, Qershinë, Fasulen, Dardhën dhe Misrin dhe tre produkte të sigurimit tradicional. Kjo masë planifikohet të zbatohet në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.

Veprimi 1.1.3 - Subvencionimi i fermerëve për kultura bujqësore për sipërfaqe/njësi dhe sasi të prodhimit për ha

Në vitin 2024, shuma totale e pagesave direkte për kultura bujqësore ishte 49,432,387.86 €, ku pjesëmarrje më të madhe në gjithsej pagesat direkte për kultura bujqësore kishin: Drithërat (74.86%), vreshtat (5.80 %) , perimet (5.78 %), ndërsa 13.56 % kategoritë e tjera.

Tabela 3 Pagesat direkte për sektorin e bujqësisë 2024 (Shuma/€ dhe Siperfaqe/kg)

Pagesat Direkte	Shuma €	Krerë/kg
Grurë	10,758,443.15	52,766.60
Gruri per kg	5,342,981.40	133,580,515.00
Farë gruri	100,593.44	696.42
Misër	10,872,454.07	47,481.78
Elb	174,401.64	854.46

Thekër	40,051.31	196.33
Tërshërë	393,402.76	1,928.32
Luledielli	365,862.54	1,031.74
Vreshta ekzistuese	2,865,802.47	2,782.49
Perime	5,367,926	9,697.16
Pemishte ekzistuese	2,856,305	5,606.26
Mjedra	339,831.31	1,699,157.70
Vera	185,651.25	2,320,640.80
Bimë medicinale dhe aromatike	97,715.52	193.76
Bujqësi organike	166,115	237.09
Fidanë	181,424.00	775,845
Perkrahje per pleh	9,323,427.00	93,238.30
Totali	49,432,387.86	

Burimi: MBPZHR (AZHB)

Veprimi 1.1.4 - Subvencionimi/ mbështetja e të ardhurave të fermave për kafshë (përveç skemës së cilësisë së qumështit)

Shuma e pagesave direkte për sektorin e blegtorisë në vitin 2024 ishte 15,029,635.14 €. Nga gjithsej pagesat direkte për sektorin e blegtorisë, për nënsektorin e qumështit janë ndare (65.40 %), për nënsektorin e bletarisë: 30.94%, ndërsa nënsektorët tjerë janë mbështetur me: 3.66 %.

Tabela 4 Pagesat direkte për sektorin e blegtorisë 2024 (Shuma/€ dhe Krerë/kg)

Pagesat Direkte	Shuma €	Sipërfaqe/krerë/kg
Lopa për qumësht	4,649,440.00	51,647
Buallica	17,820.00	99
Dhi dhe dele	3,622,325.25	142,338
Bletë	4,171,200.50	208,578
Pula vezëdhënëse	560,560.00	1,119,505
Pula pëllumbash (thëllëza)	-	-
Dosa për riprodhim	15,525.00	621.00
Qumësht	1,481,998.27	25,232,446.68
Therja e raportuar e bagëtive	39,600.00	792
Akuakulturë	51,261.12	256,305.60
Viça për majmeri	276,550.00	11,057
Meshtjerra	140,850.00	2,815
Zogj për majmeri/brojler	2,505.00	12,525
Totali	15,029,635.14	

Burimi: MBPZHR (AZHB)

Veprimi 1.1.5 - Forcimi i shërbimeve këshilluese dhe përfshirja e inovacionit si pjesa thelbësore e transferimit të njohurive

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore në MBPZhR, si çdo vit edhe për vitin 2024 ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve në nivel qendror dhe lokal, duke përkrahur dhe ofruar këshilla dhe trajnime. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjithsej 119 këshillime, kan përfituar 1,020 fermerë, prej tyre (888 burra/132 gra). 6,535 fermerë kanë marrë këshilla teknike brenda zyrave këshilluese). 2,175 fermerë janë këshilluar në mënyrë direkte në ferma, gjatë vizitave në terren nga këshilltarët. 7,598 fermerë janë informuar për mundësitë e aplikimit për grante dhe subvencione përmes QKIK-së. Janë botuar 8 tituj të broshurave informuese, janë shpërndarë rreth 4,891 ekzemplarë të materialeve informuese për fermerët dhe komunitetin. Është zhvilluar dhe dizajnuar faqja zyrtare e internetit për Shërbimet Këshilluese, me qëllim të përmirësimit të qasjes në informimata për fermerët, agrobiznese dhe biznese rurale. Gjatë vitit 2024 janë mbajtur trajnime me fermer, të cilet janë pajisur me njohuri inovative në prodhimtarinë bujqësore, numri i fermave të trajnuar 3,190.

Objektivi specifik 1.1: Mbështetje për të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe fleksibiliteti për të rritur sigurinë ushqimore

Tabela 5 Zbatimi i objektivit specifik 1.1 (Buxheti i planifikuar/i shpenzuar/€)

Veprimet	Buxheti i planifikuar/€	Buxheti i shpenzuar/€	% e realizimit
V.1.1.1	3,000,000.00	1,368,855.68	45.63 %
V.1.1.2	200,000.00	71,922.17	64.04 %
V.1.1.3	17,342,780.00	49,432,387.86	+185.03 %
V.1.1.4	11,807,220.00	15,029,635.14	+ 27.29 %
V.1.1.5	340,000.00	150,000.00	44.12%

Burimi: MBPZHR-DPZHR

Ashtu sipas përshkrimit me larte dhe prezantimit te buxhetit ne tab.1 për aktivitetin 1.1.3 ka rritje te buxhetit +185.03% dhe për Aktivitetin 1.1.4: + 27.29%. Arsyeja e rritjes se buxhetit ka te beje me lehtësimin e kriterëve për aplikim dhe me qellim te rritjes se sipërfaqeve bujqësore dhe krerëve blegtoral (përmes përfshirjes së fermerëve te vegjël).

Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave të tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe digjitalizim

Veprimi 1.2.1 Investime ne përmirësimin e infrastrukturës fizike ne sektorin e bujqësisë, përmes Masës 1: Investime në asetet fizike ne ekonomitë bujqësore

Për këtë mase janë ndarë: 15,227,000.00 €, kan aplikuar gjithsej: 1022 aplikues, sa i përket procesit të përzgjedhjes se përfituesve ky proces është duke u zhvilluar dhe ende nuk kemi projekte të kontraktuara.

Ne masën 1, si nemasa e re është përfshirë sektori i drithërave, ndërsa edhe në këtë vit është përfshirë si investim i pranuar: Blerja e lopëve qumështit të racës, me qëllim të rritjes së prodhimit të qumështit dhe përmirësimit racorë. Buxheti për këtë nën masë 1.7, arrinë vlerën: 5,000,000.00 €.

Tabela 6 Buxheti miratuar dhe numri i aplikacioneve për masën 1

Nr.	MASA 1 (Nënmasat)	Buxheti i miratuar/€	Nr.i Aplikacionëve
1.1	Pemë drufrutore	1,027,000.00	45
1.2	Arra, lajthi dhe gështenja	800,000.00	100
1.3	Pemë manore	800,000.00	29
1.4	Spektori i perimeve dhe serrave, përfshirë serrat për Fidane	2,500,000.00	235
1.5	Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, përfshirë patatet	1,000,000.00	65
1.6	Prodhimi i mishit/rritja e viçave	1,000,000.00	118
1.7	Prodhimi i mishit/rritja e derrave	200,000.00	3
1.8	Prodhimi i qumështit/lopë	5,000,000.00	333
1.9	Prodhimi i qumështit/dele dhe dhi	700,000.00	25
1.10	Pikat grumbulluese të qumështit	200,000.00	3
1.11	Prodhimi i rrushit	500,000.00	35
1.12	Prodhimi i vezëve	500,000.00	13
1.13	Drithëra	1,000,000.00	18
	Totali i buxhetit	15,227,000.00	1022

Burimi: MBPZHR (DPZHR,AZHB)

Sa i përket zbatimit të PZHR 2023, gjatë vitit 2024 janë trajtuar të gjitha aplikacionet e Masës - Investimi në asetet fizike të ekonomive bujqësore (1295 aplikues). Nga këta, bazuar në buxhetin e alokuar për këtë masë janë shpallur përfitues 401 fermerë me të cilët janë nënshkruar kontrata për zbatimin e projekteve. Kontraktimi ka përfunduar brenda vitit duke i respektuar periudhat vegetative për zbatim të projekteve varësisht nga fusha e investimeve. Është shpenzuar i tërë buxheti i paraparë për këtë masë (16,827,000.00 euro). Pas përmbylljes së kontraktimit janë Autorizuar në Total 257 projekte me vlerë prej 9.484,931.48 € pagesa finale dhe 97 paradhënie me vlerë prej 2,125,046.95 €. Totali i vlerës së autorizuar për masën 1 është 11,973,978.43 €.

Veprimi 1.2.2 Investime në përmirësimin e infrastrukturës fizike në sektorin e agro-përpunimit, përmes Masës 3: Investime në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, për këtë masë janë ndare: 3,500,000.00 € dhe kanë aplikuar 38 aplikues.

Tabela 7 Buxheti miratuar dhe numri i aplikacioneve për masën 3

Nr.	MASA 3 Nënmasat	Buxheti i miratuar/€	Nr. i Aplikuesëve
1	Përpunimi i qumështit	500,000.00	7
2	Përpunimi i mishit	500,000.00	17

3	Përpunimi i mishit te shpezeve/thertore	500,000.00	2
4	Përpunimi i pemëve dhe perimeve dhe pika grumbuluese	500,000.00	6
5	Përpunimi i verës	700,000.00	2
6	Pika grumbulluese/depot pemë perime	800,000.00	4
	Totali i buxhetit	3,500,000.00	38

Burimi: MBPZHR (DPZHR, AZHB)

Ne këtë mase kemi një zvogëlim te buxheti (2024/2023), krahasuar me vitet paraprake, si rezultat i konsuldimit te këtij sektori, fokusi është në masën 1 (Sektorin primar) nga e cila sigurohet lënda e parë për përpunim.

Sa i përket zbatimit te PZHR 2023, gjatë vitit 2024 të gjithë aplikuesit e kësaj mase janë vlerësuar. Vetëm 11 biznese janë shpallur përfituese dhe janë kontraktuar për zbatim të projektit. Nga buxheti prej 3.5 mil. euro janë shpenzuar vetëm rreth 2 mil. euro. Pjesa e mbetur e buxhetit të kësaj mase bashkë me buxhetin e mbetur nga masa 7, pjesërisht është bartur në masën 1 për nënmasën për lopë qumështore dhe pjesërisht është dhënë për marrveshjen ndërkombëtare me GIZ-in. Pas përmbylljes së kontraktimit janë Autorizuar në Total 9 Paradhënie me vlerë totale prej 881,183.40 € për përfituesit që kanë parashtruar kërkesa për paradhenie.

Veprimi 1.2.3 Përgatitja e studimeve të fizibilitetit dhe dizajnimi i projekteve teknike për rehabilitimin dhe modernizimin. Ky veprim nuk është realizuar në mungesë të mjeteve financiare. MBPZHR ka kërkuar buxhet të veçantë për realizim të këtij projekti (veprim), mirëpo nuk është aprovuar kërkesa për ndarje te mjeteve përmes KASH.

Veprimi 1.2.4 Investime ne kapitalet për rehabilitimin, modernizimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe te kullimit/drenazhit.

Gjat vitit 2024: Projekti i Ujitjes në Junik është përfunduar. 2. Projekti i Ujitjes në Deçan është përfunduar. 3. Projekti i Ujitjes në Klinë është përfunduar. 4. Projekti i Ujitjes në Mitrovicë është marrë vendim për prerje të projektit për shkak të problemeve në teren ka mbetur projekti-kontrata pa përfunduar. 5. Projekti i Ujitjes ne Vushtrri është përfunduar. 6. Projekti i Ujitjes ne Istog është marrë vendimi për ndërprerje të kontratës për shkak të problemeve në teren (Komuna e Istogut nuk ka arritur t'i zgjidhe problemet). 7. Projekti i Ujitjes në Kamenice është ndërprerë kontrata për shkak të mos-përshtatjes së Dizajnit me kontratën-paramasën. 8. Projekti i Ujitjes në Shtime është përfunduar. Gjat vitit 2024, permes projektit të BB, është investuar në Rehabilitimin dhe Modernizimin e Skemës së Ujitjes Radoniqi- Dukagjin.

Veprimi 1.2.6 Krijimi i skemës për subvencionim të interesat e kredive rurale.

Ky aktivitet ndërlidhet me mbështetje nga donatorët dhe nuk është realizuar.

Veprimi 1.2.7 Skema e subvencionimit te cilësisë së qumështit.

Si rezultat i zbatimit te këtij veprimi, janë subvencionuar: 25,232,446.68 l qumësht ne vler prej 1,481,998.27 €.

Veprimi 1.2.8: LIGJIT NR.08/L-087 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr.04/L-040 PËR RREGULLIMIN E TOKËS, gjatë vitit 2022 është hartuar dhe miratuar në Qeveri Koncept Dokumenti për Rregullim të Tokës, Gjat vitit raportues (2024) janë hartuar:

- Projekt-Ligji për Tokën Bujqësore
- Plani i Veprimit për Mbrotjen e Tokës Bujqësore

Tabela 8 Zbatimi i objektivit specifik 1.2 (*Buxheti i planifikuar/i miratuar/€*)

Veprimi	Buxheti i planifikuar/€	Buxheti i miratuar/€	Dallimi në %
V.1.2.1	15,227,000.00	15,227,000.00	100%
V.1.2.2	3,500,000.00	3,500,000.00	100%
V.1.2.3	500,000.00	0.00	0.00%
V.1.2.4	1,038,332.00	685,851.00 +699,562.53 ²	66.05%
V.1.2.6	500,000.00	00	0.00%
V.1.2.7	2,050,000.00	1,481,998.27	72.29%

Burimi: MBPZHR-DPZHR

Objektivi specifik 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës

Veprimi 1.3.1 Ligji për Organizimin e Tregut të produkteve bujqësore, ka përfunduar në dhjetor të vitit 2022 dhe është miratuar në Qeveri me datë 22.02.2023. Në kuadër të këtij veprimi është në proces të përgatitjes U/A për themelimin e grupeve prodhuese. Grupet e prodhuesve të krijuara me këtë U/A do të ndihmojnë fermerët të përballen së bashku me sfidat e tregut dhe të forcojnë fuqinë e tyre negociuese në lidhje me prodhimin dhe marketingun, duke përfshirë edhe tregjet lokale, prandaj kjo mase ndikon në përmirësimin e pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës. Në vitin 2024 janë hartuar tri (3) Udhëzime Administrative (U/A), të cilat dalin nga Ligji për Organizimin e Tregut të Përbashkët. Grupi punues për hartimin e planit për përmirësimin e ndërmarrjeve agro-shqimore ka përgatitur një draft të dokumentit, duke përfshirë analizën SWOT.

3.1.2 Objektivi Strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore

Objektivi specifik 2.1: Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen në ndryshime klimatike, si dhe energjinë e ripërtëritshme

Veprimi 2.1.1 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në energjinë e ripërtëritshme 5% nga buxheti M1 dhe M3 (Aktivitet i pa përfunduar – Procesi i vlerësimit të projekteve është duke vazhduar). Ndërsa në vitin 2023, nga zbatimi i PZHR-se, janë instaluar 2664.6 Kw energji të ripërtëritshme (nga burimet solare/fotovoltarike).

² Buxhet i ndarë nga BE/BB

Veprimi 2.1.2 Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura:

Planifikimi i Pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura për vitin 2024 nuk është realizuar pasi që: pas përfundimit të procedurave të prokurimit nga ana e APK-së , është konstatuar se nuk ka O.E të përgjegjshëm, pra nuk i plotëson kriteret për pyllëzim të sipërfaqeve të zhveshura sipas specifikave të kërkuara nga APK. Kurse 0.95 ha janë pyllzuar nga Organizata CNVP në periudhën Janar-Mars në Regjionin e Prizrenit-Komuna Dragash.

Veprimi 2.1.3 Hartimi i planeve menaxhuese.

Gjatë vitit 2024 janë aprovuar njëzet e dy (22) plane vjetore të menaxhimit me vendgjueiti të përbashkëta dhe katër (4) plane afatgjata të menaxhimit me vendgjieuti të përbashkëta.

Është hartuar Plani i Veprimit për Task Forcën për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e paplanifikuara urbane, i cili është proceduar në Qeveri për aprovim.

Sa i përket Hartimit të Planeve Menaxhuese Afatgjata te pylltarise, është nënshkruar Kontrata për Hartimin e Planeve Menaxhuese afatgjata në sipërfaqe prej 18,079.60 ha, e cila për shkaqe atmosferike nuk mund të përfundoj punën këtë vit,pasi që punimet janë edhe në terren, por kompania fituese pritët të filloj punën në vitin 2025, (dhe O.E do të paguhet nga buxheti i vitit 2025, edhe pse tenderi është shpallur në vitin 2024).

Tabela 9 Zbatimi i objektivit specifik 2.1 (Buxheti i planifikuar/i miratuar-shpenzua/€)

Veprimi	Buxheti i aprovuar/€	Buxheti i shpenzuar/€	Dallimi në %
V 2.1.1	936.350	1,070,532.70	+14.33 %
V 2.1.2	320,000	0.00	0.00%
V 2.1.3	250,000	250,000	0.00%

Burimi: MBPZHR- DPZHR

Objektivi specifik 2.2: Mbështetje në nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të tokës, ujit dhe ajrit.

Veprimi 2.2.1 Prezantimi i praktikave të mira bujqësore dhe mjedisore që synojnë përmirësimin e balancës bruto të lëndëve ushqyese (për shembull, moslejimi i aplikimit të plehrave në sezonin e ftohtë ose në tokat me borë ose ujë). Ky veprim ndërlidhet me veprimin nr. 1.1.5: Janë shpërndare rreth 4,891 broshura/fletëpalosje për fermer dhe komunitetin. 6535 fermer janë përkrahur me këshilla teknike ne zyre ne QIKK dhe 2175 fermer me këshilla direke, gjatë vizitave ne ferma 200,000 € ishin planifikuar, ne vitin 2023, por nuk janë shpenzuar për shkak te vonesave ne kontraktimin e projektit për shërbime këshillimore.

Veprimi 2.2.3 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në depot e plehut për menaxhimin e plehut organik. Nga buxheti i masës 1 " Investime në asetet fizike të ekonomive

bujqësore ", 10 % ose 1,682,000.00 € janë dedikuar ne ndërtimin e depove për menaxhimin e plehut organik.

- Depo për menaxhim të plehut ne stallat e lopëve për prodhim të qumështit;
- Depo për menaxhim të plehut për stalla për viça dhe
- Depo për menaxhim të plehut në stalla për derra.

(Aktivitet i pa përfunduar – Procesi i vlerësimit te projekteve është duke vazhduar).

Objektivi specifik 2.3: Mbështetje në mbrojtjen e biodiversitetit, shërbimet e zgjeruara të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve:

Nuk ka pas veprime te planifikuara për vitin 2024.

3.1.3 Objektivi Strategjik 3: Mbështetje për bizneset në zonat rurale, rritjen e punësimit dhepërmirësimin e infrastrukturës sociale

Objektivi specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, përfshirë bio-ekonominë dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pylltarisë.

Veprimi 3.1.1 Grantet për diversifikimin e njësive lokale ushqimore dhe zinxhirit të furnizimit të shkurtër dhe për bizneset rurale jo-bujqësore. Buxheti i ndarë (2024) për këtë veprim është 5,000,000 €. Masa 7 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, si rezultat i marrëveshjes ndërkombëtare me GIZ-in Gjerman: Ligji Nr.08/L-252 për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës , e përfaqësuar nga MBPZHR dhe Deutsche Gesellschaft fur Zusammenarbeit (GIZ) GMBH për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë ne zonat rurale , do të zbatohet nga GIZ-i. Vlera totale e buxheti është 20,200,000.00 euro, periudha e zbatimit: 2024-2027, niveli i mbeshtetes është: 50%-50%.

Në këtë mase jan të përfshira nënmasat si në vijim.

Tabela 10 Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve/Nënmasat

Nr.	MASA 7 (Nënmasat
7.1	Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve pyjore jo drusore përfshirë bimët mjekësorë dhe aromatike
7.2	Zhvillimin e turizmit rural dhe agro - turizmi
7.3	Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare
7.4	Prodhimi i mjaltit
7.5	Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale
7.5.a	Përpunimi i leshit të deleve
7.5.b	Prodhimi i humusit
7.6	Rritja e shpezëve të fshatit
7.7	Kultivimi i peshkut
/	Totali i Buxhetit: 5,00,000,00 €

Burimi: MBPZHR-AZHB

Masa do të zbatohet në tri Lote:

Tabela 11 Projektet sipas lotëve (Vlera e mbështetjes/€, shkalla e përkrahjes/%)

LOT – Kostot e pranueshme të investimit	Buxheti / %
LOT 1 projekte në shkallë të vogël Projekti: gjenerimi i të ardhurave: - Vlera e projektit te pranuar min. 1,500 euro – max. 5,000 euro kosto të pranueshme - Lloji i mbështetjes: prokurimi i mallrave dhe shërbimeve/dorëzimi i pajisjeve. Norma e ndihmës: 100 %	34.6
LOT 2 projekte të vogla - të mesme Projekti: gjenerimi i të ardhurave: - Vlera e projektit te pranuar min. 5,0001euro – max. 50,000 euro kosto të pranueshme - Lloji i mbështetjes: mbështetje jo e rimbursueshme, paradhënie - Norma e ndihmës:70 % e kostove të pranueshme të investimit	34.6
LOT 3 projekte në shkallë të gjerë: - Vlera e projektit te pranuar:50,0001 euro – max. 350,000 euro kosto të pranueshme. - Lloji i mbështetjes: mbështetje jo e rimbursueshme, paradhënie - Norma e ndihmës: 65 % e kostove të pranueshme të investimit	30.8
Skema totale e grantit Lot 1+2+3	100

Burimi: GIZ

Sa i përket procesit të zbatimit, nga GIZ-i është shapllur thirja për aplikim (Mars 2025) për LOT-in 3/Projekte në shkallë të gjerë, ndërsa lotët tjera (1 dhe 2) pritet të shpallen gjat vitit 2025)

Ndërsa nga zabtimi i PZHR, me koretisht masa 7 kanë aplikuar 561 aplikues, janë vlerësuar 253 prej tyre dhe nuk janë trajtuar 308 aplikacvione të nënmasës së turizimit rural, duke u bazuar në marrëveshjen me GIZ-in. Nga 253 aplikacionet e trajtuara, 50 fermerë janë shpallur përfitues dhe kanë lidhur kontrata për zbatimin e projekteve të tyre në vlerë 1.9 mil. euro. Buxheti i pashfrytëzuar prej 1.7 mil. euro është bartur për zbatimin e marrëveshjes me GIZ-in.

Pas përmbylljes së miratimit dhe kontratave janë Autorizuar në total 43 projekte me vlerë 1,042,099.13 € pagesa finale dhe 17 paradhanie në vlerë prej 217,106.61 €. Totali i vlerës së autorizuar për masën 7 është 1,259,183.74 €.

Veprimi 3.1.2 Mbështetja e iniciativave të zhvillimit lokal rural përmes mbështetjes së

GLV-ve, faza e Përgatitjes së Strategjive të Zhvillimit Lokal - Masa 5 “Përgatitja dhe zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale (SZhL). Buxheti i ndarë për këtë veprim është 300,000.00€, ndërsa numri i aplikantëve 12.

Tabela 12 Buxheti miratuar dhe numri i aplikacioneve për Masën 5: përgatitja dhe zbatimi i staegjive zhvillimre lokaler -LEADER

MASA 5 (Nënmasa)		€	Nr.	Nr.
		Buxheti	Aplikant	Perfitues
5.1	Grupet Lokale të Veprimit/GLV	300,000.00	12	-

Burimi: MBPZHR/AZHB

Tabela 13 Zbatimi i objektivit specifik 3.1 (*Buxheti i planifikuar/i miratuar/€*)

Veprimet	Buxheti i planifikuar/€	Buxheti i miratuar/€	Dallimi ne %
V 3.1.1	5,000,000.00	5,000,000.00	100
V 3.1.2	300,000.00	300,000.00	100

Burimi: MBPZHR/DPZHR

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve

Veprimi 3.2.1 Bujqësia organike – subvencionimi/kompensimi për fermerët që zbatojnë rregullat e bujqësisë organike janë mbështetur 237.09 ha ne vlere prej 166,115.00€.

Sa i perket hartimit te plotikave dhe legjislacionit: Grupi punues ka finalizuar draftin e Koncept Dokumentit për Bujqësi Organike, i cili është dërguar në Qeveri për aprovim në mbledhjen e radhës.

Veprimi 3.2.2 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në standardet e mirëqenies së kafshëve, duke stimuluar kështu reduktimin e përdorimit të antimikrobikëve veterinarë,

Nga buxheti i Masës 1 “Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore: 25% është dedikuar për përmirësimin e mirëqenies së kafshëve, Ne vitin 2023: 59 fermer kanë investuar ne përmirësimin e mirëqenies se kafshëve. Ndersa ne vitin 2024 është ne proces te vlerësimit te projekteve nga zabtimi i PZHR 2024.

Tabela 14 Zbatimi i objektivit specifik 3.2 (*Buxheti i planifikuar/i shpenzua/€*)

Veprimet	Buxheti i aprovuar €	Buxheti i shpenzuar €	% e buxhetit te shpenzuar
V 3.2.1	150,000.00	166,115.00	+10.74
V3.2.2	4,206.750.00	0.00	0.00

Burimi: DPZHR/AZHB

Sa i perket legjislacionit që nderlidhet me standard e mirëqenjes së kafshëve, janë aprovuar:

- UA (MBPZHR) NR. 27/2024 - për kushtet teknike që duhet t'i plotësojnë mbarështruesit e kafshëve shoqëruese për mbajtje, dhurim dhe shitje.
- U/A Nr.01/2024 për Identifikimin dhe Regjistrimin e kafshëve, është aprovuar nga Ministri i MBPZHR me 15.03.2024.
- UA (MBPZHR)-NR.14/2024- për përcaktimin e rregullave të kontrollit zyrtar për kafshët e gjalla që hyjnë në terrotiron e Republikës së Kosovës.

Ndersa është hartuar Projekt-Ligjit për Veterinarinë dhe Koncept Dokumenti për Sëmundjet e Kafshëve është finalizuar dhe aktualisht gjendet në procesin e konsultimeve publike.

Objektivi specifik 3.4: Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cënueshme

Në PZHR 2024: Masën 1 /Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, është vazhduar me masa afirmative: 2 pikë shtesë për femrat aplikuese ky kriter vlen për dy sektore: sektorin e prodhimit të bimave dhe sektorin e prodhimit të shtazëve.

Ndërsa në masën 7 /Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, kemi një mbështetje më të madhe, numri i pikëve shtesë për femra është nga 5 -10:

Në mungesë të të dhënave për vitin 2024 (*Procesi i vlerësimit të projekteve dhe përzgjedhja e përfituesve përfundimtar nuk ka përfunduar*), po i paraqesim të dhënat për vitin 2023, ku nga zbatimi i PZHR 2023 kanë përfituar: 107 gra ose 21.4%. Nga Masa 1: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore: 77 përfituese. Masa 3: Investime në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore: 1 përfituese dhe Masa 7:Diversifikimi dhe zhvillimi i bizneseve në zona rurale 29 përfitues.

3.1.4 Objektivi Strategjik 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase

Objektivi specifik 4.1 Arritja e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masa të programit IPARD III (Riorganizimi dhe funksionalizimi i plotë i AZHB-së si Agjenci IPARD)

Ngecje ka pasur edhe në veprimet të cilat kanë qenë të planifikuara të zbatohen përmes financimit nga donatorët. Planifikimi i donatorëve shpesh nuk korrespondon me vitin e planifikimit dhe ndarjes buxhetore që ministria bënë. Aktualisht është duke u zbatuar projekti i GIZ-it në vlerë prej 7 milionë euro , financuar nga Komisioni Evropian me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të AZHB-së drejt plotësimit të kriterëve dhe standardeve për qasje në fondin e para-anëtarësimit në BE.

Veprimi 4.1.1 Ngritja e kapaciteteve të Autoritetit Menaxhues, të njësisë së asistencës teknike për qasje në buxhetin IPARD III (duke lejuar MBPZHR të mbulojë kostot nga fondet e IPARD-it si menaxhimi i programit, monitorimi, vlerësimi dhe zbatimi.

Është duke u implementuar projekti me vlerë prej 7 milionë euro nga GIZ, financuar nga Komisioni Evropian me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të AZHB-së drejt plotësimit të kriterëve dhe standardeve për qasje në fondin e para-anëtarësimit në BE. Pjesë e përfitimeve nga asistenca teknike e projektit ishte edhe AM.

Nga ekspertët e GIZ-it, Ka filluar procesi i analizës së gjendjes për procesin e akreditimit (Planifikohet akreditimi i dy masave nga PZHR, gjashtë është duke u bërë edhe analiza e gjendjes së AZHB-së).

Veprimi 4.1.2 Asistencë teknike dhe trajnime për harmonizimin e mëtejshëm me rregulloret dhe dispozitat teknike të kapitujve 11, 12 dhe 13 të BE

Gjatë vitit 2024 nuk është identifikuar ndonjë trajnim specifik për këtë qëllim përveç mësimit në punë, megjithatë ky veprim është i gjerë dhe në vazhdimësi janë disa projekte të BE-së në vitet në

vijim që do të adresojnë këtë veprim i cili është shumë i rëndësishëm për proceset që Kosovën e presin në vitet në vijim. Gjatë vitit 2024, përmes TIEK-t janë realizuar misione të mbështetjes teknike për përgatitjen e U/A dhe masave/veprimeve.

Veprimi 4.1.5 Prezantimi i praktikave të mira bujqësore dhe mjedisore, ky veprim është i ndërlidhur me veprimin 1.1.5. Gjatë vitit 2023 janë shpërndarë rreth 4891 broshura/fletëpalosje për fermer dhe komunitetin: 6535 fermerë përkrahur me këshilla teknike në zyre në QIKK dhe 2175 fermerë me këshilla direkte, gjatë vizitave në ferma.

Veprimi 4.1.7 Përgatitja e hartave GIS të tokës/inventarit të tokës/ dheut.

Sistemi i thjeshtëzuar i identifikimit të parcelave të tokës është funksional dhe është duke u përdorur për të gjithë fermerët, të cilët kanë aplikuar për sipërfaqe si dhe inspektorati i AZHB-ës është duke bërë verifikimin e parcelave të dixhitalizuara tek të përzgjedhurit për kontroll në teren.

Veprimi 4.1.9 Fuqizimi i Departamentit të Shërbimeve Këshillimore. Në vitin 2024 ka pas një progres të avancuar pasi që gjatë këtij viti është përgatitur Plani Strategjik i shërbimeve këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, i mbështetur nga Caritas-i Gjerman, ku parashikohet avancimi i sistemit të shërbimeve këshillimore dhe krijimi i 7 zyrave regjionale për shërbime këshillimore. Megjithatë ende mbetet sfida numri i vogël i stafit të Departamentit.

Veprimi 4.1.10 Forcimi i kontrollit të MBPZHR-së për licencat e lëshuara për BMA-të e egra dhe PPJD. Ky veprim është zbatuar plotësisht, pasi që sipas procedurave dhe kriterëve për shfrytëzimin dhe grumbullimin e prodhimeve jo drusore të malit (PPJD) dhe bimëve aromatike (BMA), Departamenti i Pylltarisë ka licencuar subjekte për shfrytëzimin dhe grumbullimin e këtyre prodhimeve në pyje.

Veprimi 4.1.11 Studimi mbi potencialin turistik natyror dhe antropik dhe krijimi i një sistemi të regjistrimit për operatorët e turizmit rural

Gjatë vitit 2024 nuk është bërë ndonjë veprim konkret:

Objektivi specifik 4.2: Digjitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive dhe inovacionit.

Veprimi 4.2.1 Digjitalizimi i MBPZHR-së, dhe politika e të dhënave të hapura

Në kuadër të këtij veprimi janë realizuar disa aktivitete/projekte:

- *Sistemi Informativ i Tregut: Pjesa e futjes së të dhënave është finalizuar nga Projekti IPA 2015 "Capacity Building in relation to the EU Common Market Organisation (CMO) and Agricultural Statistics".*
- *Në mbështetje të FAO-së është duke u punuar në digjitalizimin e shërbimeve që ofrohen nga MBPZHR, është krijuar GP dhe ka filluar punën.*
- *Sistemi Informativ i Pyjeve të Kosovës (SIPK), është duke u zhvilluar nga Projekti i implementuar nga FAO. Ky sistem është ngarkuar tani edhe në rrjetin qeveritar. Ekspertët*

e angazhuar nga FAO kanë mbajtur trajnime lidhur me përdorimin e sistemit SIPK, ku trajnimi ka zgjatur 5 ditë pune. Pjesëmarrës kanë qenë zyrtarë nga APK - DMP dhe nga DKR - Prizren, gjithashtu kanë marrë pjesë edhe stafi profesional i ekspertëve të rinjë të angazhuar nga projekti i implementuar.

- *Digjitalizimi i certifikatave në kuadër të CEFTA-SEED, ka sjellë përmirësim të kontrolleve kufitare për import dhe eksport;*
- *Digjitalizimi/Përmirësuar kushtet teknologjike dhe monitorimi përmes dronëve, GPS-ve dhe kamerave kurth, duke kontribuar në ruajtjen dhe zhvillimin e pyjeve. Për herë të parë, u trajtua sëmundja e gështenjës dhe nisi inventarizimi i pyjeve për krijimin e të dhënave të sakta mbi gjendjen e tyre.*
- *Sistemi i Integruar Informativ Bujqësor SIIB sipas nevojës është ri-freskuar me të dhëna.*
- *Në kuadër të projektit projekti IPA 2015 Organizimin e Tregut të Përbashkët (OPT) dhe Statistikat Bujqësore", sa i përket komponentit të statistikave është zhvilluar data baza për Sistemin Informativ të Tregut.*

Veprimi 4.2.2 Përmirësimi i sistemit të IT-së, Në këtë vit janë bërë disa iniciativa të cilat janë përkrahur nga GIZ-i.

Veprimi 4.2.5 Transferimi i njohurive mbi Global GAP (për fermerët) dhe HACCP (për AVUK-un). Ne mungesë të mbështetjes buxhetore/teknike nga donatoret, ky aktivitet nuk është realizuar në vitin 2024, ky aktivitet ndërlidhet edhe me veprimin 1.1.5. Megjithatë ky është veprim që duhet vazhduar në të cilin mund të kontribuojnë edhe donatoret. Digjitalizimi i certifikatave në kuadër të CEFTA-SEED+ ka sjellë modernizim dhe përmirësim të kontrolleve kufitare për import dhe eksport, ndërsa monitorimi i sëmundjeve të kafshëve dhe trajnimi i inspektorëve ka përforcuar kapacitetet për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive. Gjithashtu, kontrollet e koordinuara janë intensifikuar për identifikimin e kontrabandës dhe rritjen e sigurisë së produkteve ushqimore,

Veprimi 4.2.6 Ngritja e kapaciteteve të Institutit Bujqësor të Kosovës për kontrollin fitosanitar të operatorët e biznesit ushqimor të mund të përmbushin standardet e BE-së për sigurinë ushqimore dhe të përmirësojnë konkurrencën e tyre. Ky veprim nuk është realizuar për shkak të dështimit të prokurimit publik me kohë. IBK vazhdon të përgatis raporte laboratorike për AUV-in dhe palët tjera të interesit bazuar në standarde.

Veprimi 4.2.8 Transferimi i njohurive nga vendet e tjera të BE-së për zbatimin e iniciativave lokale. Nuk ka pasur progres, ka qenë i ndërlidhur me financim nga donatoret.

Veprimi 4.2.9 Ngritja e rrjetit kombëtar rural.

Nuk ka pasur progres, ka qenë i ndërlidhur me financim nga donatoret

4 VLERËSIMI I ARRITJEVE KRYESORE

4.1 Histori suksesi

Janë mbështetur përmes subvencioneve: 32,317.00 fermerë, parë gjatë vitit fiskal, janë përmbyllën te gjitha procedurat e parapara ligjore duke filluar nga kontrolli administrativ, kontrolli në teren, përgatitja e vendimeve për mbështetje ne vlere prej 64,462,023.00 €, ku pjesa me e madhe eshte ekzekutar per pagese ; Vlen të përmendet se gjatë vitit 2024 vlere e skemave të përkrahjes së Pagesave Direkte ishte rreth 6% me e lartë krahasur me vitin 2023 (60.6 mil.ion euro);

Nga viti 2023/2024 kemi një përmirësim/thjeshtëzim te procesit te aplikimit, ku fermerët vetëm përmes një deklarate nën betim mund te aplikojnë, pa pasur nevojë te nxjerrin dokumente (Fletëpalosje, Kontrata). Kjo ka bërë që të kemi rritje të sipërfaqeve, me theks te veqant të sektorit të drithërave (grurë edhe misër), ndërsa në vitin 2024, kemi edhe rritje te rendimentit te grurit për 2 t.

Ne projektet/grantet e zhvillimit rural, është bërë një progres në zgjerimin e investimeve në nënsektore të reja: Blerjen e lopë qumështore të racës dhe mekanizmi për sektorin e drithërave (grurë dhe misër), kategorizimin e investimeve për njësi te prodhimit (me qellim te shfrytëzimit racional te buxhetit), përfshirja e mases se re për sigurime bujqësore/primet. Përmes zbatimit te kësaj mase do të mbulohet kostoja e dëmeve të shkaktuara në bujqësi nga fatkeqësitë natyrore (200,000.00 euro). Dhënia e afatit shtese prej 5 ditëve fermerëve për kompletim te dosjes/aplikacionit për dokument te cilat gjëndërohen ne MBPZHR. Ky kriter ua mundëson fermerëve aplikues qe te mos refuzohen ne mungesë te një dokumenti i cili gjenerohet në ministri. Masa 7/Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve në zonat rurale, do të zbatohet përmes GIZ-it, si rezultat i Marrëveshje ndërkombëtare: (Ligjit Nr.08/L-252 për këtë masa janë ndare 20,200,000 euro, do të jetë bashkëfinancim (50%/50%).

Sa i përket vleresimit te indikatorëve fizik, ekonomik dhe mjedisorë të granteve të PZHR për vitin 2023, kemi një progres te theksuar:

96% (487) e aplikueseve kanë investuar në energji të ripërtërishme dhe kanë prodhuar gjithsej 2,665 kilovat energji të ripërtrishme;

60% (294) e përfituesve kanë qenë fermer të rinj;

36% (182) e përfituesve janë ndërmarrje të reja;

36% (182) e përfituesve investimet e tyre i kanë bërë në lokacione me lartësi mbidetare më të madhe se 700m;

169 përfitues kanë angazhuar student të rinj;

15% (73) e përfituesve kanë investuar në ndërtim/zgjerim shtalle;

71 përfitues kanë investuar në blerjen e traktorëve të rinj;

7% (37) e përfituesve kanë investuar në ndërtim dhe zgjerim të objektit;

6% (32) e përfituesve kanë investuar në ndërtim të depos së plehut;

4% (22) e përfituesve kanë investuar në diversifikim të prodhimeve.

411 përfitues nga total numri i përfituesve kanë krijuar vende të reja pune.

Sa i përket investimeve kapitale kemi një progres në realizimin e projekteve të rehabilitimit të sistemit të ujitjes: Projekti i Ujitjes në Junik, Deçan, Klinë, Vushtrri dhe Shtime është përfunduar me sukses, përfshirë edhe investimet nga projekti i BB/BE: Rehabilitimi dhe Modernizimi i Skemës së Ujitjes Radoniqi- Dukagjin.

Në kuadër të sigurimit të transparencës:

MBPZHR/AM ka organizuar 4 Sesione informuese për masat e përfshira në PZHR, në 4 regjione të Kosovës. Në këto sesione, kanë qenë të pranishëm një numër i konsiderueshëm i fermerëve dhe përfaqësuesve të agrobizneseve të vendit, rreth 150 pjesëmarrës.

Janë përgatitur dhe publikuar:

- *Postera njoftues për të ftuar bujqit dhe agrobizneset në sesione informuese;*
- *Shtypjen dhe vendosjen e rollapëve zyrtarë para fillimit të sesioneve (në dy gjuhë);*
- *Shtypjen dhe shpërndarjen e 200 fletëpalosjeve zyrtare (në dy gjuhë);*

Ndërsa secilit fermer/agrobiznes/biznese rurale, ju ka mundësuar e drejta për tu ankuar për projekte/grante të zhvillimit rural, Në vitin 2024 nga 380 ankesa të parnuara nga zbatimimi i PZHR 2023: Janë miratuar 71 ankesa. Ankesat e fermerëve/agrobizneseve/bizneseve rurale, nga zbatimi i PZHR 2024, janë në proces të pranimit/shqyrtimit.

Progres është arritur në avancimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e bujqësisë dhe pylltarisë, gjatë priudhës raportuese janë hartuar dhe aprovuar:

- *Amandamentimi i Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-27;*
- *Programi për Pagesa Direkte 2024*
- *Programi i Zhvillimit Rural 2024*
- *Plani i Veprimit për Task Forcën për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e paplanifikuara urbane, i cili është proceduar në Qeveri për aprovim.*
- *Hartimi i Planeve Menaxhuese Afatgjata për Pyje/Nenshkrimi Kontrates në sipërfaqe prej 18,079.60 ha, e cila për shkaqe atmosferike nuk mund të përfundojë punën këtë vit (Kompania fituese pritët të fillojë punën në vitin 2025).*
- *Hartimi i Projektligjit për veterinarinë, i cili aktualisht gjendet në fazën e konsultimeve paraprake.*
- *Hartimi i Koncept Dokumentit për Bujqësi Organike*
- *Hartimi i Koncept Dokumentit për Mbrojtjen e Bimëve*
- *Udhëzime Administrative*

Lidhur me reformat institucionale, MBPZHR është në proces të përgatitjes teknike për akreditimi të masave (2) të PZHR dhe akreditim të AZHB-se. Përmes mbështetjes së GIZ-it është duke u bërë analiza e zbrastirave dhe identifikimi i nevojave. Është bërë amandamentimi (plotësim/ndryshimi i PKBZHR 2023-27, janë përgatitur programet njëvjeçare për subvencione dhe projekte të zhvillimit rural, është përgatitur baza ligjore për zbatim, ndërsa sa i përket AZHB-se po thuhet se është

pavarësuar financiarisht, duke i kryer/ekzekutuar pagesat, është miratuar organogrami i ri, është digjitalizuar një pjesë e shërbimeve te procesit te aplikimit dhe kontrollit.

Sa i përket procesit të digjitalizimit të shërbimeve në sektorin e bujqësisë, MBPZHR ne bashkpunim me FAO -ne dhe palë tjera të interesit ka filluar procesin e konsultimeve publike për përgatitjen e Programit dhe Planit të Veprimit për Bujqësinë Digjitale: 2025 – 2028.

Ne kuadër të pyllëzimit dhe mirëmbajtjes se pyjeve, gjat vitit raportues janë pyllëzuar dhe mirëmbajtja e 105 ha të sipërfaqeve të zhveshura (Prej tyre nga buxheti i APKsë do të pyllëzohen 100 ha, ku 5 ha do të pyllëzohen nga CNVP), dhe mirëmbajtja e pyllëzimeve në sipërfaqe prej 142,8 ha të pyllëzara në vitin 2023. Gjithashtu janë kultivuar 1,000,200 fidane për pyllëzime ne vitin 2025. Ndërsa në kudër të luftimit dhe parandalimit të veprimeve ilegale në pyje, me propozim të MBPZHR-së dhe Vendim të Qeverisë, është bërë themelimi i Task Forcës, si si trup koordinues ndërinstytucional.

Gjithashtu është themeluar Task Forcës për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore nga Ndërtimet e Paplanifikuara Urbane dhe Degradimin e saj. Task Forca, e cila është funksionale;

Sa i perket ndryshimeve klimatike, te cilat kanë sjellur sfida të mëdha për sektorin bujqësor, për të adresuar këto probleme, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka përshtatur shpërndarjen e subvencioneve dhe granteve, duke i orientuar ato për të rritur produktivitetin dhe për t'i ndihmuar fermerët të përballojnë konkurrencën në treg dhe për të ju përshatur ndryshimeve klimatike, gjithashtu jan pergatitur raporte dhe broshura;

Progres ka pasur edhe ne avancimin e shërbimeve keshillimore, eshte vazhduar me këshillimin dhe trajnimin e fermerëve, gjithashtu gjat periudhës raportuese jan certifikuar 80 keshlltarë bujqësore.

Lidhur me identifikimin e objektivave operationale dhe veprimeve/masave të cilat ndërlidhen me zbatimin e objektivat strategjike te MBPZHR, tashëm është përgatitor plani Institucional i punës për periudhën: 2025-27. Tashme MBPZHR ka pergatitur Planin instucional për periudhën: 2025-27 dhe aty ka vendur prioritete dhe masat/veprimet, sipas sektorëve)

Bashkpunim me donatorë/projekte:

- Gjatë vitit 2024 përmes projektit të Swiss Kontakt-it, është bërë vlerësimi i ndikimit te granteve (serra). DPZHR.ne kuader te këtij projekti është dizajnuar pyetësori, është përgatitor metodologjia e punës, janë realizuar 245 anketa nga 671 përfitues në sektorin e serrave, duke siguruar një përfaqësim të nivelizuar rajonal dhe një shtrirje sipas viteve 2014-2022. Rezultatet e vlerësimit janë prezantuar përmes Platformës se vlerësimit te granteve. Kjo platformë është krijuar me qëllimin për të mundësuar një vlerësim më të thelluar dhe të bazuar në të dhëna, duke u siguruar që fondet publike të përdoren në mënyrën më efektive dhe të qëndrueshme.
- Ratifikimi ne Kuvend Marrëveshja në mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Gjermane në vlerë prej 20.2 milion € për grante në agroturizëm, ekoturizëm dhe zhvillim rural nga të cilat 10.2 milionë janë financim i Qeverisë Gjermane. Gjithashtu 9.2 milion euro grant nga Komisioni Evropian për Investime dhe ngritje të kapaciteteve në sistemin e ujitjes dhe 7 milion € është vlera e cila do të përkrahet nga AZHB.

- Është duke u implementuar projekti me vlerë prej 7 milion € nga GIZ, financuar nga Komisioni Evropian me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të AZHB-së drejtë plotësimit të kriterëve dhe standardeve për qasje në fondin e para-anëtarësimit në BE;
- European Commission (EU) – World Bank (WB) Partnership Programme Part III permes projektit: Improvement and Rehabilitation of Irrigation Systems Project (IRIS)
- Përgatitja e propozimit për IPA III Fuqizimi i së Ardhmes së Qëndrueshme Bujqësore të Kosovës: Ndërtimi i Qëndrueshmërisë ndaj Klimës, Përmirësimi i Qasjes në Treg dhe Forcimi i Jetesës në Zonat Rurale. Duke u fokusuar në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, praktikat e qëndrueshme bujqësore dhe inovacionin, projekti mbështet Kosovën në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim në BE dhe arritjen e pajtueshmërisë me ligjet dhe standardet e BE-së.
- Sa i përket Agjendës së gjelbër, (Projekti: EU4 Green/Agjenda për shtetet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia 11 000 000 EUR Kontributi i BE 10 000 000 EUR dhe Kontributi i Agjencionit për Mjedisi Austriak : 1 000 000 EUR Ka filluar me 01.01.2022 dhe zgjatë deri 31.12.2025 48 muaj). Lidhur me këtë proces, MBPZHR është në proces të përgatitjes së tregueseve agro-mjedisor (përfshirë kapitujt kombëtarë) dhe perspektivat për përmirësim në vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu është përgatitur edhe Raporti për adaptim/ përshtatje ndaj ndryshimeve Klimatike (për disa sektorë të Bujqësisë).
- Sa i përket zhvillimit të aktiviteteve në kuadër të digjitalizimit, MBPZHR përkrahur nga FAO është në proces të zhvillit të Programit dhe Planit të Veprimit për Bujqësinë Digjitale në Kosovë 2025–2028, ku janë identifikuar objektivat kryesore të cilat do të ndikojnë në procesin e digjitalizimit si dhe po hulumtohen/identifikohen aktivitetet të cilat do të zhvillohen.
- Gjithashtu në kuadër të planit të integritetit po realizohet aktiviteti “Raportimi i të dhënave administrative dhe ndarja e informacioneve”, ku është krijuar fonderi i përbashkët (shared fonderi) i MBPZHR-së, i cili përmban dokumentet relevante dhe të dhënat statistikore për gjitha Departamentet dhe Agjencitë në kuadër Ministrisë, i njëjti sapo të plotësohet me dokumente dhe të dhëna nga secila njësi e Ministrisë do të shërbejë tërë stafit të institucionit për të pas qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në informacion.
- Rishikimi i shpenzimeve publike për pagesat direkte në sektorin e bujqësisë. Në kuadër të objektivit të Kosovës për t'u anëtarësuar në BE, ky rishikim i shpenzimeve publike krahason struktura ekzistuese të pagesave direkte në Kosovë me PPPB të BE-së (CAP). Duke pasur parasysh përgatitjet për integrimin në BE, rekomandimet në këtë raport mbështeten në kërkesat institucionale, administrative dhe të politikave të PPB-së (CAP). Shuma e alokuar e buxhetit: 9,150,000.00 €. Financuar nga Ministria Federale për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin për Klimën, Ekipi Ekonomik Gjerman (GET).
- Statusi i zbatimit të aktiviteteve deri më 31 dhjetor 2024 (EUR)

Fondi i mirëbesimit	Shuma totale e grantit	Zotimet *	Disbuimets	Fondet e mbetura**
Komp 1: Rehabilitimi dhe Modernizimi i Skemës së Ujitjes Radoniqi- Dukagjin	8,340,000.00	1,510,000.00	699,562.53	7,640,437.47

Komp 2: Ngritja e kapaciteteve për të rritur efikasitetin e përdorimit të ujit dhe produktivitetin e bujqësisë.	470,000.00	250,000.00	187,932.00	282,068.00
Komp 3: Menaxhimi i Projektit, Koordinimi, Monitorimi dhe Vlerësim.	340,000.00	196,500.00	127,577.47	212,422.53

* (i gjithë bilanci i fondit konsiderohet i zotuar për BE-në për vitin 2024)

** (buxheti i mbetur nga disbursimi nga shuma totale e grantit)

5 VLERËSIMIN E SFIDAVE, MANGËSIVE DHE PENGESAVE

Jo të gjitha veprimet/ nevojat e identifikuar për arritje të objektivave janë pranuar për tu financuar nga MF. Edhe pse Strategjia është aprovuar në Qeveri, MFPT nuk ka pranuar të financojë asnjë veprim që ka kosto jashtë KASH-it.

Sigrimi i buxhetit për veprime për të cilat nuk është ndarë buxhet, mund të kërkohet nga MF buxhet shtesë përmes planit të ri të veprimi: 2025-27.

Vreshtari ka pasur në zbatimin e projekteve që ndërlidhen me procedurat të prokurimit dhe me donatorët. Disa veprime që janë planifikuar të mbështeten nga donatorët nuk janë realizuar në këtë vit për shkak të vonësive në fillimin e zbatimit të tyre.

Sfide mbetet përkrahja nga donatorët, ku për shkak të masave të BE-së disa projekte kanë mbetur pezull;

Një problematike e cila duhet të adresohet ka të bëjë me bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve në mes të palëve të interesit, të cilat janë të shumta në sektorin e bujqësisë, marrë për bazë ndikimin e këtij sektori në shumë sektorë tjerë.

6 RESURSET BUXHETORE

Buxheti i republikës së Kosovës;

BE;

Donatorët tjerë bilateral dhe

Sektori privat.

7 KONKLuzionet dhe Rekomandimet për Hapat e Ardhshëm

Marrë në përgjithësi është arritur një progres i konsideruar në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimor rural, si rezultat i zbatimit të SBZHR 2022-2028.

Bazuar ne procesin e monitorimit , po thuajse shumica e masave/veprimeve (2024) janë zbatuar, përjashtim bëjnë disa investime kapitale, te cilat nuk janë realizuar ne tërësi, ndërsa ngecje ka pasur ne masat/veprimet te cilat ndërlidhen me financim nga donatoret kryesisht qe ndërlidhen me Objektivin Strategjik 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase. Ndërsa sa i përket granteve jan ne proces te zbatimin (ka perfudnuar procesi i aplikimit është duke vazhduar procesi i vlerësimit (per disa nenmasa ja shpallur rezultatet)

Sa i përket rekomandimeve, bazuar në kërkesat e sektorit, orietimi zhvillimor duhet te jetë ne sektorin e ujitjes dhe tokës. Sot nuk mund te imagjinohet prodhimtaria bujqësore intensive pa sistemin e ujitjes dhe pa konsolidimet te tokave bujqësore.

Sa i përket rekomandimeve per te ardhmen, duhet të analizohen dhe adresohen rekomandimet e eskepertëve të BE-së, në Raportin vjetor te progesit 2024:

- Zbatimin e subvencioneve me masa të kushtëzuara:
 - *Kushtëzim me futjen e racave blegtorale me prodhimtari te lartë, dhe varieteteve te fidanëve me potencial me te lartë te prodhimit me qëllim që plotësojnë standardet e cilësisë dhe garantojnë sigurimin e cilësisë; (Sa i përket sektori të blegtorisë tashme janë përzgjedh racat me potencial të lart prodhues të cilat financohet përmes granteve të PZHR).*
 - *Kushtëzim duke u bazuar në numrin e hektarëve (të sipërfaqes bujqësore të shfrytëzuar) për respektimin e praktikave të mira bujqësore, duke përfshirë përmirësimet në ndërtesat dhe infrastrukturën e fermave;*
 - *Kushtëzim me pagesat për prodhimin e të mirave publike,duke përfshirë adoptimin e praktikave për:*
 - *Kontrollin e përdorimit të plehrave kimike dhe mjeteve kimike për kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve;*
 - *Ruajtja dhe krijimi i habitateve dhe*
 - *Të mbroj tokën nga erozioni i tokës, të gjitha të përcaktuara në një plan të miratuar të menaxhimit mjedisor.*
- Sistem të forta të menaxhimit dhe kontrollit per sigurinë ushqimore. Zbatimi i rregullave të përbashkëta të BE-së për standardet e marketingut, politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike. Perputhja e masave mbështetëse me acquis të BE-së. Fuqizimi dhe ruajtja e kapaciteteteve, ndërmarrja e hapave drejt zhvillimit të një sistemi të integruar të administrimit dhe kontrollit, rrjetit të të dhënave për qëndrueshmërinë e fermave.
- Zbatimi i Ligjit për organizimin e tregut të produkteve bujqësore është miratuar në dhjetor të vitit 2023. Legjislacioni zbatues i tij duhet të përgatitet.
- Në politikën e cilësisë, Kosova vazhdoi të përparojë me regjistrimin e një treguesi të dytë geografik. Megjithatë, procesi i regjistrimit dhe kontrolli duhet të përafrohet me acquis të BE-së. Për bujqësinë organike, legjislacioni duhet të përafrohet me acquis të BE-së, duhet të zbatohet plani kombëtar i veprimit organik 2023-2026 dhe duhet të ndërmerren veprime për t'i dhënë përparësi bujqësisë dhe prodhimit organik si një element ndërsektorial në kuadër të programit kombëtar për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Pergatitja e një Plani të veprimit për të adresuar humbjen dhe degradimin e tokës bujqësore.

Një element shumë i rëndësishëm që duhet të merret parasysh është edhe zhvillimi institucional dhe ridizajnimi i politikave:

Vazhdimi i investimeve kapitale për Rregullimin/Konsuldimin e Tokës dhe Rehabilitimin e Sistemit të Ujitjes;

Përgatitja e raportit për adaptim/ përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike (për disa sektorë të bujqësisë), e cila do të ndihmonte në zbatim të Agjendës së Gjellbër;

Sa i përket reformave institucionale, fokusi duhet të jete në përgatitjet teknike për akreditimit të AM dhe AZHB-së (Përmes mbështetjes së GIZ-it, është duke u bërë analiza e zbatuesirave dhe identifikimi i nevojave),

Gjithashtu prioritet duhet të jete edhe digjitalizimi i sektorit të bujqësisë përmes platformës digjitale (E-Bujqësia), MBPZHR në mbështetje të FAO-së, është duke u përgatitur: PROGRAMIN DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR BUJQËSINË DIGJITALE 2025 - 2028;

Është e rëndësishme që të vazhdohet me avancimin e shërbimeve këshillimore të fermave përmes digjitalizimit, me qëllim që mbështetja publike e dhënë përmes granteve dhe subvencioneve për fermerët të maksimizohet përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe inovacionit.

Harmonizimi në mënyrë progresive me standardet e BE-së dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, i cili do të siguroj përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të shoqërisë për ushqim të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm;

Lehtësimi i zhvillimit të biznesit dhe punësimit në zonat rurale, do të përmirësoj pozicionin e fermerëve në organizimin e prodhuesve dhe në zinxhirin e vlerës dhe të tërheqë fermerët e rinj. Gjithashtu do të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe të nxisë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

8 RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Rreziqet që janë hasur gjatë monitorimit të zbatimit të këtij dokumenti kanë të bëjnë me:

- *Kapacitetin institucional;*
- *Kapacitetin financiar;*
- *Partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera si dhe faktorët e tjerë të jashtëm që ndikojnë në nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik.*

Kapacitetin institucional

Një numër i veprimeve nuk janë realizuar ose janë vonuar për shkak të kapaciteteve të limituara institucionale, buxhetore, vonesat e zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe faktor tjerë.

Kapaciteti financiar

Strategjia është Miratuar nga Qeveria e Kosovës, megjithatë MFPT nuk ka ndarë buxhet për zbatimin e veprimeve të reja që do të ndikonin në arritjen e objektivave, veprimet janë realizuar

vetëm me buxhetin ekzistues. Veprimet e reja dhe inovative të përfshira në strategji, për zbatimin e tyre ka mbetur të kërkohej mbështetje nga donatorët.

Partneriteti dhe angazhimi i institucioneve të tjera

Mungesë e kapaciteteve në mobilizimin e partnereve të tjerë (donatorëve) dhe investues të ndryshëm për të financuar veprimet të cilat nuk janë financuar nga buxheti i Kosovës.

Bashkpunimi dhe koordinimi në vazhdimësi me institucionet/palet tjera të interesit, që kërkesat dhe veprimet e ndërlidhura me SBZHR-se të adresohen, në mënyrë që ky dokument të jetë i zbatueshëm.

Pjesë integrale e raportit është Matrica e raportimit për zbatimin e planit të veprimit të SBZHR 2022-2028 (Shtojca 1) dhe Tabela e Vlerësimit të indikatorëve të zbatimit të SBZHR 2022-28

SHTOJCA I

9. Matrica e raportimit (2024) për zbatimin e Planit të veprimit të SBZHR 2022-2028³

Objektivat/Veprimet	Afati ifundit	Buxheti (€) Planifikuar/ Shpenzuar 2024	Burimi i financimit	Përgjegjësit për raportim	Produkti/Outputi	Referencë të dokumenteve	Progresi izbatimit
Objektivi strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës							
Objektivi specifik 1.1: Mbështetje për të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe elasticiteti për të rritur sigurinë ushqimore							
1.1.1 Kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore	2023	Divizioni i Financave_ Te plotësohet: Buxheti i planifikuar: Buxheti i shpenzuar: 1,368,855.68 €.	Buxheti KP: 47600- DNB-SB	DPBT- Komisioni i i ankesave	Komisioni ka aprovuar: 1,012 kërkesa nga 24 komuna, në vlerë prej: 2,826,464.05. €, ku nga kjo vlerë janë kompensuar 82%.	KASH (Bazuar ne Vendimin e Qeverisë së Kosovës.(Nr. 30/112, datë 13.12.2022).	Progresi i plotë
1.1.2 Skemat e sigurimit në bujqësi (kultura bujqësore dhe kafshë nga buxheti i subvencioneve)	Vjetore 2024	200,000/0.00 €	Buxheti KP:40100 DPB-SB	DPBT, AZHB	Janë mbështetur 86 fermer / polisa te sigurimit nga fatkeqësitë natyrore.	KASH PSO	Ne proces: Masa është perfshire ne PZHR 2024, bazuar ne Ligjin Nr.08/L- 072 për bujqësi dhe zhvillim Rural. Neni 21.Nenparagrafi: 1.1.Sigurimin e kulturave bujqësore,

³ Në mungesë të të dhënave për vitin 2024, ju kemi rferuar vitit 2023.

1.1.3 Subvencionimi/ mbështetja e të ardhurave të fermave për kultura bujqësore për sipërfaqe/ njësi dhe sasi të prodhimit	Vjetore 2024	17,342,780/ 49,432,387.86 €	Buxheti KP:40100 -SB	AZHB	Kanë aplikuar gjithsejt 32,317 fermerë. (përfshir edhe fermeret nga S.Blegtoris), ëahtë bërë kontrolla administrative, vlerësimi dhe aprovimi i aplikacioneve (100%), janë realizuar kontrollat aplikacionet të përzgjedhura për kontroll (1200) Janë perkrahur per gjithsejte kulturat e aplikuar: 41,288 perfitues në vlerë Eshte bërë realizimi i pagesave të parapara për të gjithë përfituesit ne vlere prej: 49,432,387.86 € . <u>Siperfaqet e subvncionuara:</u> 103,923.91 ha drithëra, 1,031.74 ha lulediell, 2,782.49 ha vreshta, 5,606.26 ha peimshte ekzist., 9,697.16 ha perime, 237.09 ha bujqësi organike, 193.76 ha BMA, 775,845 ha fidanë,133,580,515 kg grur 2,320,640.80 l vere, 93,238.30 kg përkrahje per pleh.	KASH	Progresi i plotë
1.1.4 Subvencionimi/ mbështetja e të ardhurave të fermave për krerë (kafshë, shpez,blete) (përveç skemës së cilësisë së qumështit)	Vjetore 2024	11,807,220/ 15,029,635.14 €	Buxheti KP 40100- SB	AZHB	Nga Sektori i Blegtorisë janë perkrahur gjithsejte 10,845 përfitues në vlerë totale prej 15,029,635.14 € . <u>Kreret e subvencionuara:</u> 51,647 lop, 99 buallica, 142,338 dele dhe dhi, 208,578 blete, 1,119,505 pula, 11,057 viqa,	KASH PSO	Progres i plotë

					2,815 meshqerra, 12,525 brojler, 621.00 dosa, 256,305.60 kg akuakulture (peshk)792 krer therje te raportuar,		
1.1.5 Forcimi i shërbimeve këshilluese dhe përfshirja e inovacionit si pjesa thelbësore e transferimit të njohurive	Vjetore 2024	340,000/ 200,000/	Buxheti KP:40400 -MSH	DSHKT	Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjithsej 119 këshillime, kanë përfituar 1,020 fermerë, prej tyre (888 burra/132 gra). 6,535 fermerë kanë marrë këshilla teknike brenda zyrave këshilluese). 2,175 fermerë janë këshilluar në mënyrë direkte në ferma, gjatë vizitave në terren nga këshilltarët. 7,598 fermerë janë informuar për mundësitë e aplikimit për grante dhe subvencione përmes QKIK-së. Janë botuar 8 tituj të broshurave informuese, janë shpërndarë rreth 4,891 ekzemplarë të materialeve informuese për fermerët dhe komunitetin. Gjatë vitit 2024 janë mbajtur trajnime me fermer, të cilet janë pajisur me njohuri inovative në prodhimtarinë bujqësore, numri i fermereve të trajnuar 3,190.Është zhvilluar dhe dizajnuar faqja zyrtare e internetit për Shërbimet Këshilluese, me qëllim të përmirësimit të qasjes në informimata për fermerët, agrobiznese dhe biznese rurale.		Progresi i plotë

Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave të tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe dixhitalizim							
1.2.1 Grantet për investime: M 1 /Investime në asetet fizike të fermave bujqësore	Vjetore 2024	15,627,000.00 / 0.00	Buxheti KP: 40700-SB 40700/DPZHR:	AZHB	Ka perfudnuar procesi i aplikimit dhe eshte duke vazhuar procesi i shyrtimi dhe vleresimit te aokaicionve/projekteve nga AZHB	KASHPSO PRE	Progres është duke vazhduar kontraktimi i përfituesve, ne fazë finale
1.2.2 Grantet për investime : M 3: Investime në asetet fizike që kanë të bëjnë me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit M3)	Vjetore 2024	3,500,000/ 0.00	Buxheti KP: 40700: 40700 -SB	AZHB	Ka perfudnuar procesi i aplikimit dhe eshte duke vazhuar procesi i shyrtimi dhe vleresimit te aokaicionve/projekteve nga AZHB	KASH PSO PRE	Progres i limituar, është duke vazhduar procesi i kontrolles administrative/vlerësi mit te aplikacioneve
1.2.3 Përgatitja e studimeve të fizibiliteti dhe dizajnit të projekteve teknike për rehabilitimin, modernizimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit	Vjetore 2024	500,000/0.00	Buxheti i Kosovës KP:40100-Kapitale	DPBT	Nuk ka progres:	KASH PSO PRE	Nuk ka progres:
1.2.4 Investime kapitale për rehabilitimin, modernizimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe të kullimit/drenazhit	Vjetore 2024	2,130,000/ 685,851 € +699,562.53 €	Buxheti i Kosovës KP:40100-Kapitale dhe Donatorët (BE/BB)	DPBT	Investimet kapital për ujitje kane përfunduar në Junik, Deçan, Klinë, Vushtrri dhe Shtime dhe janë në proces në disa komuna tjera.	KASH PSO PRE	Progres i plotë:
1.2.6 Krijimi i skemës për subvencionimin të interesat të kredive rurale	Vjetore 2024	0.00/00	N:500,000 Donator	Buxheti KP nuk është identifikuar Donatorët	Ky aktivitet ndërlidhet me mbështetje nga donatorët.	KASH	Nuk ka progres, në mungesë të donacioneve.
1.2.7 Skema e cilësisë së qumështit - subvencionim për qumështin e dorëzuar në fabrikat e përpunimit ose qendrat grumbulluese sipas nivelit të cilësisë (cilësi më e lartë - nivel më i lartë i subvencionimit)	Vjetore 2024	2,050,000/ 1,481,998.27	Buxheti KP:40100-SB	AZHB	Gjat vitit raportues janë subvencionuar: 25,232,446.68 l qumesh, në vlerë prej 1,481,998.27 euro	KASH PSO	Progres i plotë:

Objektivi strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore							
Objektivi specifik 2.1: Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen me ndryshimet klimatike, si përdorimin e energjisë se ripërtitshme							
2.1.2 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në energjinë e rinovueshme 5% nga buxheti M1 dhe M3	Vjetore 2024	19,127,000.00 5% e totalit të (M1 +M3) + 956,350.00 €	Buxheti KP:40700 -SB	AZHB	Në proces të vlerësimit të aplikacioneve dhe përzgjedhjes së përfituesve potencial. Ndërsa në vitin 2024, nga zbatimi i PZHR 2023, 487 përfitues kanë investuar në energji të ripërtitshme: 2.665 kw.	KASH PSO	Progresi i pjeshëm:
2.1.3 Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	Vjetore 2024	320,000/142,2 26.77	Buxheti KP 40300-Kapit.	APK	Ne kuadër të pyllëzimit dhe mirëmbajtjes së pyjeve, gjat vitit raportues janë pyllëzuar dhe mirëmbajtja e 105 ha të sipërfaqeve të zhveshura (Prej tyre nga buxheti i APKsë do të pyllëzohen 100 ha, ku 5 ha do të pyllëzohen nga CNVP), dhe mirëmbajtja e pyllëzimeve në sipërfaqe prej 142,8 ha të pyllëzara në vitin 2023. Gjithashtu janë kultivuar 1,000,200 fidane për pyllëzime në vitin 2025.	KASH PSO	Progres i plotë:
2.1.4 Hartimi i planeve menaxhuese	2024	250,000/250,000	Buxheti KP 40300-Kapit.	APK	Sa i përket Hartimit të Planeve Menaxhuese Afatgjata, është nënshkruar Kontrata për Hartimin e Planeve Menaxhuese afatgjata në sipërfaqe prej 18,079.60 ha, e cila për shkak të atmosferike nuk mund të përfundojë punën këtë vit, pasi që punimet janë edhe në terren, por kompania fituese pritët të fillojë	KASH PSO	Progres i plotë:

					punën në vitin 2025, (dhe O.E do të paguhet nga buxheti i vitit 2025, edhe pse tenderi është shpallur në vitin 2024).		
Objektivi specifik 2.2 : Nxitja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të burimeve (toka, uji, ajri)							
2.2.1 Prezantimi i praktikave të mira bujqësore dhe mjedisore që synojnë përmirësimin e balancës bruto të lëndëve ushqyese (për shembull, moslejimi i aplikimit të plehrave në sezonin e ftohtë ose në tokat me borë ose ujë)	Vjetore	200.000/71,922.17	Buxheti KP:40400:PM 40400-M&SH	MBPZHR, Shërbimet Këshillimore	Gjatë periudhës raportuese janë shpërndarë rreth 4,891 ekzemplarë të materialeve informuese për fermerët dhe komunitetin. Është zhvilluar dhe dizajnuar faqja zyrtare e internetit për Shërbimet Këshilluese, me qëllim të përmirësimit të qasjes në informimata për fermerët, agrobiznese dhe biznese rurale	Raportet nga Qendrat Informative Këshilluese Komunale(QIKK) dhe raporti vjetor i DSHKT	Progresi i pjesshëm:
2.2.3 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në depot e plehut për menaxhimin e plehut organik (Vjetore/pjesë e buxhetit për M1/Sektorit të blegtorisë: Lope viça/derra/shpez)	Vjetore	6,700,000.00 €. 5% e totalit të + 335,000.00 €	Buxheti KP: 40700-SB	MBPZHR, AZHB	Ne proces të vlerësimit të projekteve. Ndërsa në vitin 2024, nga zbatimi i PZHR 2023, 32 perfitues kanë investuar në ndërtim të depotëve të plehut.	KASH PSO	Progres i pjesshëm
Objektivi specifik 2.3: Mbrojtja e biodiversitetit, përmirësimi i shërbimeve të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve/natyrës							
2.3.1 Menaxhimi i gjerë i kullotave për tokat me biodiversitet të lartë në zonat me vlerat e dëshmuara të biodiversitetit, si zonat e mbrojtura.	2023	0.00/0.00	N:500,000 Donatore		MBPZHR	KASH PSO	Nuk ka progres
Objektivi strategjik 3 - Zhvillimi i bizneseve të zonave rurale dhe rritja e punësimit dhe infrastrukturës sociale							
Objektivi specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, duke përfshirë ekonominë bio							
3.1.1 Grantet për diversifikimin e njësive lokale ushqimore dhe zinxhirëve të furnizimit të shkurtër dhe për bizneset	Vjetore 2024	5,000,000/0.00	Buxheti KP: 40700-SB	AZHB	Masa 7 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, si rezultat i marrëveshjes	KASH PSO PRE	Progres i limituar, është duke vazhduar procesi i

rurale jo-bujqësore					ndërkombëtare me GIZ-in Gjerman: Ligji Nr.08/L-252 për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës , e përfaqësuar nga MBPZHR dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GMBH për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në zonat rurale , do të zbatohet nga GIZ-i.		kontrollës administrativë/vlerësimit të aplikacioneve
3.1.2 Mbështetja e iniciativave të zhvillimit lokal rural përmes mbështetjes së GLV-ve	Vjetore	200,000/0.00 €	Buxheti KP: 40700-SB	AM ,AZHB	Kanë aplikuar 12 GLV, për përgatitjen e strategjive të zhvillimit lokal - Qasja LEADER.	KASH PSO PRE	Progres i limituar, është duke vazhduar procesi i kontrollës administrativ/vlerësimit të aplikacioneve
3.1.3 Projekti për infrastrukturën publike rurale, rrugë e vreshtave në Komunën e Rahovecit	Vjetore	350,000/.00 €	Buxheti KP: 45800- KP	DPBT - DVV	Gjat kësaj periudhe është përgatitur specifikacioni Teknik dhe kërkesa është proceduar në zyrën e prokurimit për zhvilloimin e procedurave të cilat kanë deshtuar..	KASH PSO	Nuk ka progres

Objektivi specifik 3.2 : Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve

3.2.1 Bujqësia organike – subvencionimi / kompensuese për fermerët që zbatojnë rregullat e bujqësisë organike, pasi prodhimi i tyre është zakonisht më i ulët ndaj ndalimit të plehrave kimike dhe pesticideve	Vjetore	150,000/ 166,115 €	Buxheti KP: 40100-SB	MBPZHR, AZHB	Janë mbështetur: 237.09 ha	KASH PSO	Progresi i plotë:
3.2.2 Prioritizimi i granteve për fermerët me investime në standardet e mirëqenies së kafshëve, duke stimuluar kështu reduktimin e përdorimit të antimikrobikëve veterinarë (Vjetore pjesë e buxhetit për M1/Spektori i blegtorisë).	Vjetore	25% e buxhetit nga masa 1. 7,200,000 €	KP:40700-SB	AZHB	Është duke vazhduar procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve.	KASH PSO	Progresi i plotë:

Objektivi strategjik 4 - Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për krijimin e shërbime publike më efikase							
Objektivi specifik 4.1 Arritja e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masat e programi IPARD III							
4.1.1 Ngritja e kapaciteteve të Autoritetit Menaxhues, të njësive së asistencës teknike për qasje në buxhetin IPARD III (duke lejuar MBPZHR të mbulojë kostot nga fondet e IPARD-it si menaxhimi i programit, monitorimi dhe vlerësimi dhe zbatimi drejtë besimit për menaxhim të buxhetit të IPARD III)	2023/24	N: 24,000 Nacional	N:24,000 IPA:1,500,000 Donatore	AM Donoret	Në vitin 2023, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) ka arritur funksionalizimin e plotë, duke shënuar një përparim të rëndësishëm në menaxhimin dhe mbështetjen e sektorit bujqësor. Që nga atëherë, agjencia ka krijuar dhe aktivizuar të gjitha njësitë e nevojshme për realizimin efikas të pagesave dhe prokurimit, duke siguruar një proces transparent, të shpejtë dhe të besueshëm për fermerët dhe partnerët e saj. Ky funksionalizim ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve administrative dhe në zbatimin efektiv të politikave bujqësore, duke e pozicionuar AZHB-në si një aktor kyç në zhvillimin ekonomik të sektorit. Megjithatë, në zbatimin e veprimeve të planifikuara përmes financimit nga donatorët janë hasur disa ngecje. Planifikimi i	PSO PRE	Progres i plotë – Në proces

				donatorëve shpesh nuk korresponдон me vitin fiskal dhe ndarjen buxhetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), duke vështirësuar koordinimin dhe realizimin e masave. Aktualisht, po zbatohet projekti i GIZ-it me vlerë prej 7 milionë euro, i financuar nga Komisioni Evropian, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të AZHB-së drejt përmbushjes së kriterëve dhe standardeve për qasje në fondin e para-anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ky veprim synon të mundësojë që MBPZHR të mbulojë kostot e menaxhimit të programit, monitorimit, vlerësimit dhe zbatimit përmes fondeve IPARD. Në kuadër të projektit të GIZ-it, është përfshirë edhe asistencë teknike për Autoritetin Menaxhues, që është pjesë e përfitimeve për ngritjen e kapaciteteve të AZHB-së. Ekspertët e GIZ-it kanë nisur procesin e analizës së gjendjes për procesin e akreditimit, duke planifikuar akreditimin		
--	--	--	--	---	--	--

					e dy njësive nga MBPZHR dhe duke realizuar analizën e përgjithshme të AZHB-së.		
4.1.2 Asistencë teknike dhe trajnime për harmonizimin e mëtejshëm me rregulloret dhe dispozitat teknike të kapitujve 11, 12 dhe 13 të BE	N/A	N: 100,000 Donatore	Buxheti KP:40700- MSH BE , IPA III TAIEX	Departament tet Ministritë, AZHB dhe AUVK	Te gjitha projektet ligjet janë epergaditur dhe perafuar me legjislacionin BE, per mesë pergaditjes se tabelave te perputheshmer me rregulloret e BE.	MSA PSO PRE	Progres i pjesshëm , në mungese të donacioneve.
4.1.3 Hartimi i një Plani të Veprimit për zbatimin e Agjendës së Gjellbër të Ballkanit Perëndimor	2024/25	Donator	N:500,00 Donatore	MBPZHR/ Donatorët	Pergatija e Raportit për adaptim/ përshtatje ndaj ndryshimeve Klimatike (për disa sektorë të Bujqësisë), e cila do te ndihmonte ne zbatim te Agjendës se Gjellbër; pjesmarrje ne takime te perbashketa.	Projekti: EU4Green/ Agjenda për shtetet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, B. Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia 11 000 000 EUR Kontributi i BE 10 000 000 EUR dhe Kontributi i Agjencionit për Mjedisin Austriak : 1 000 000 euro.	Progres - Vazhdon
4.14 Përgatitja e indikatorëve bazë të kontekstit sektorial dhe e indikatorëve mjedisorë të kontekstit	2024	Donator	N:300,00 Donatore	MBPZHR/ Donatorët	-	MSA - TAIEX	Nuk ka progres, në mungesë të donacioneve.

4.1.5 Prezantimi i praktikave të mira bujqësore dhe mjedisore	2023/2024	20,000.00/00	Buxheti KP:40400-MSH BE , IPA III TAIEX	Donatorët / TAIEX	Mungesa e donatorëve	-	Nuk ka progres, në mungesë të donacioneve.
4.1.6 Hartimi i një Kodi të praktikave të mira bujqësore për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes me nitrare të shkaktuar nga bujqësia	2023/2024	N:100,000/00 Donatore	Buxheti KP:40400-MSH BE , IPA III TAIEX	MBPZHR/ Donatorët	Mungesa e donatorëve	-	Nuk ka progres, në mungesë të donacioneve.
4.1.7 Përgatitja e hartave GIS të tokës/inventarit të tokës/ dheut (GIS- Geographic Information System- Mapping; SIGJ- Sistem i Informacionit Gjeografik – Hartëzimi)	2023/2024	460,000.00/00	Buxheti KP:40400-MSH BE , IPA III TAIEX	MBPZHR/ Donatorët	Mungesa e donatorëve	-	Nuk ka progres
4.1.9 Fuqizimi i Departamentit të ShërbimeKëshillimore	2023/2024	Në kuadër të buxhetit për paga.	Buxheti KP: 40400-MSH BE , IPA III TAIEX	DSHKT	Është përgatitë dhe miratuar Plan Strategjik i Shërbimeve Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, është në proces të zbatimit.	KASH	Progresi i plotë
4.1.10 Forcimi i kontrollit të MBPZHR-së për licencat e lëshuara për BMA-të e egra dhe PPJD	2023/2024	Në kuadër të buxhetit për paga	Buxheti KP:40600-PMBE , IPA III TAIEX	DPBT/DP	Realizimi i Planit vjetor dhe plotësimi i kriterëve licencimit.		Progresi i plotë
4.1.11 Studim mbi potencialin turistik natyror dhe antropik dhe krijimi i një sistemi të regjistrimit për operatorët e turizmit rural.	2023/2024	0.00/00	BuxhetiKP: 40700-MSHBE , IPA III TAIEX	MBPZHR /Donatorët	Në mungesë të donacioneve.		Nuk ka progres

Objektivi specifik 4.2: Digjitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive dhe inovacionit							
4.2.1 Digjitalizimi i MBPZHR-së, dhe politikave të dhënave të hapura	Vjetore 2024	100,000/	Mbeshtetur nga Donatoret		-Sistemi Informativ i Tregut, është finalizuar nga Projekti IPA 2015 "Capacity Building in relation to the EU Common Market Organisation (CMO) and Agricultural Statistics". -Ne mbshtetje te FAO-se eshte duke u punar ne digjitalizmin e sherbimeve qe ofrohen nga MBPZHR, eshte krijar GP dhe ka filluar punen. -Sistemi Informativ i Pyjeve të Kosovës (SIPK) është duke u zhvilluar nga Projekti i implementuar nga FAO . Ky sistem është ngarkuar tani edhe në rrjetin qeveritar -Digjitalizimi i certifikatave në kuadër të CEFTA-SEED+ ka sjellë modernizim dhe përmirësim të kontrolleve kufitare për import dhe eksport; -Digjitalizimi/Monitorimi përmes dronëve, GPS-ve dhe kamerave kurth, duke kontribuar në ruajtjen dhe zhvillimin e pyjeve. Për herë të parë, u trajtua sëmundja e gështenjës dhe nisi inventarizimi i pyjeve për krijimin e të dhënave të sakta mbi gjendjen e tyre.	100,000/	Progres jo i plotë

4.2.2 Përmirësimi i sistemit të IT-së, për Menaxhim të politikave	2023/2024	135,000	Buxheti KP:47400-KP Donatoret	AZHB	Është Angazhuar një programor për periudhën 2 vjeçare për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të menaxhimit të granteve dhe subvencioneve.	KASH PSO	Progres jo i plotë
4.2.3 Fushata sensibilizuese për bujqësinë organike, KKBBP-ja, mbi Kodin e Praktikave të Mira Bujqësore për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes me nitrato të shkaktuar nga bujqësia dhe për hedhjen e paligjshme të mbetjeve	2023/2024	N: 100,000/00 Donatore			Mungesa e donacioneve		Nuk ka progres
4.2.4 Transferimi i njohurive të MBPZHR-së, dhe organizatat e fermerëve për marketing duke përdorur zinxhirët e shkurtër të furnizimit	2023/2024	N: 100,000/00 Donatore	Donatorët TAIEX	MBPZHR / Donatorët	Mungesa e donacioneve		Nuk ka progres
4.2.5 Transferimi i njohurive mbi Global GAP (për fermerët) dhe HACCP (për AVUK-un)	2023/2024	100,000 Donatoret	TAIEX	MBPZHR /AVUK/ Donatorë t	Mungesa e donacioneve		Nuk ka progres

SHTOJCA II

Nr.	Objektivat/Indikatoret	Vlera bazë (2019)	Targeti afatmesëm (2024)	Targeti përfundimtar Viti (2028)	Vlerësimi /2024 ⁴
I.	Objektivi strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agroushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës				
1	Treguesi i ndikimit 1.1: Vlera e shtuar bruto	477 mil. euro 7.2%	+10%	+20%	658 mil. € + 38% / 2023 Bruto Produkti Vendor (BPV) për vitin 2023 shënoi 9,680.1 mil.€. Ndërsa BPV për kokë banori për vitin 2023 ishte 6.101 €
2	Treguesi i ndikimit 1.2: Punë shtesë (në njësi pune vjetore)	82,657 AWU	+3%	+5%	DAESB (në vitin 2019 është reviduar kjo e dhënë në anketën e ekonomive bujqësore) dhe vazhdon të mbetet e njëjta
3	Treguesi i ndikimit 1.3: Produktiviteti i punës	5,771 euro/AWU	+6.8%	+14.28%	6,596 euro/AWU + 14.30 % (2022)
I.i	Objektivi specifik 1.1 - Mbështetje për të ardhura të qëndrueshme të fermës dhe elasticiteti për ta rritur sigurinë ushqimore				
1	Treguesi i prodhimit 1.1: Numri i përfituesve nga numri total i ekonomive bujqësore	44.40%	50%	60%	48.20%
I. ii.	Objektivi specifik 1.2 - Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit ndaj kërkesave të tregut duke u fokusuar në kërkime, inovacion, teknologji dhe digjitalizim				
1	Treguesi i prodhimit 1.2: Bilanci tregtar agroushqimor (raporti eksport/import)	1:11.68	1:9	1:7	Raporti eksport import në vitin 2024 është: 1:8. Sa i përket shkëmbimit tregtar të produkteve bujqësore me vendet e tjera, Kosova ka eksportuar produkte bujqësore në vlerë prej 148.00 mil. € në vitin 2023, që shënon një rritje prej 24.8% krahasuar me vitin paraprak. Në të njëjtën periudhë, importi ka arritur në 1,285.00 mil. €, duke sjellë një bilanc tregtar negativ prej 1,137.00 mil. €, me një rritje prej 5.5% krahasuar me vitin 2022. %. Kjo tregon që

⁴ Ne rastet kur nuk ka pasur të dhëna për vitin 2024, janë paraqitur të dhënat për vitin 2023.

					eksportet janë rritur më shpejt se importet, duke bërë që raporti tregtar të përmirësohet nga 1:11.68 në 1:8.7, dhe është një idikacion i përmirësimit të bilancit tregtar gjatë periudhës 2019-2023.
I. iii.	Objektivi specifik 1.3 - Përmirësimi i pozicionit të fermerëve në zinxhirin e vlerës				
1	Treguesi i prodhimit 1.3: Vlera e shtuar neto për NJPV në bujqësi	1,428 euro	1,571 euro	1,728 euro	DAESB (nuk ka të dhëna sepse FADN nuk është zhvilluar nga viti 2020)
II.	Objektivi strategjik 2 - Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore				
1	Treguesi i ndikimit 2.1: Erozioni i tokës nga uji (Pjesa e sipërfaqeve totale të mbuluara nga toka me erozion të fortë dhe shumë të fortë)	23.45	-2%	-5%	n/a
2	Treguesi i ndikimit 2.2: Bujqësia me vlerë të lartë natyrore (HNV).	N/A	Mesatarja e BE-së: 33.14% nga totali i SBSH	Mesatarja e BE-së: 33.14% nga totali i SBSH	n/a
3	Treguesi i ndikimit 2.3: Cilësia e ujit – Nitratet në ujërat nëntokësore	N/A	Mesatarja e BE-së 50 mg NO3 për litër/mesatare vjetore	Mesatarja e BE-së 50 mg NO3 për litër/mesatare vjetore	n/a
II.i	Objektivi specifik 2.1 - Mbështetje në zbutjen dhe në përshtatjen me ndryshimet klimatike, si përdorimin e energjisë së ripërtëritshme				
1	Treguesi i prodhimit 2.1: Pjesa e emetimeve të GHG nga bujqësia	7%	0 rritje	0 rritje	7% apo 746 GgCO2 eq. (2022) vlerësohet merr pjesë kategoria: Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi i tokave në Emetimet e përgjithshme të gazrave serrë në Kosovë 10,617 Gg (Giga gram) CO2 eq. (ekuivalent), raportuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, ndërsa në raport me vitin 2019 ka rënë për (-3.5%), 746 GgCO2 eq. (2019)
II. ii.	Objektivi specifik 2.2 - Nxitja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të burimeve (toka, uji, ajri)				
1	Treguesi i prodhimit 2.2.1: Bilanci bruto i lëndëve ushqyese	N/A	Mesatarja e BE-së 44kg/N/ha	Mesatarja e BE-së 44kg/N/ha	n/a
2	Treguesi i prodhimit 2.2.3: Pjesa e UAA me	7.35%	-2%	-5%	n/a

	erozion shumë të fortë të tokës nga uji				
3	Treguesi i prodhimit 2.2.4: Emetimet e amoniakut nga bujqësia	N/A	Mesatarja e BE-së: 93% nga burimet bujqësore	Mesatarja e BE-së: 93% nga burimet bujqësore	n/a
II. iii.	Objektivi specifik 2.3 - Mbrojtja e biodiversitetit, përmirësimi i shërbimeve të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve/natyrës				
1	Treguesi i prodhimit 2.1: Numri i ha UAA sipas skemave agromjedisore dhe klimatike	0	10	50	n/a
III.	Objektivi strategjik 3 - Zhvillimi i bizneseve të zonave rurale dhe rritja e punësimit dhe infrastrukturës sociale				
1	Treguesi i ndikimit 3.1: Shkalla e punësimit rural	N/A	Mesatarja e BE-së 73.07%	Mesatarja e BE-së 73.07%	Shkalla e punësimit rural: 24.62 % (Shkalla e papunesise ne zonat rurale: 80.50%/ femra, 67.6% meshkuj (Burimi: Rinia Rurale në Kosovë)
2	Treguesi i ndikimit 3.2: Shkalla e varfërisë rurale	N/A	Mesatarja e BE-së 20.90%	Mesatarja e BE-së 20.90%	n/a
3	Treguesi i ndikimit 3.3: GDP rurale për kokë	N/A	Mesatarja e BE-së: 20,067 euro/banor	Mesatarja e BE-së: 20,067 euro/banor	n/a
III. i.	Objektivi specifik 3.1-Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale,duke përfshirë ekonominë bio				
1	Treguesi i prodhimit 3.1: Numri i vendeve të punës në zonat rurale në sektorin jobujqësor	N/A	Mesatarja e BE-së: 88%	Mesatarja e BE-së: 88%	n/a
2	Treguesi i prodhimit 3.2 Numri i GLV	12	20	30	12
III. ii.	Objektivi specifik 3.2 - Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve				
1	Treguesi i prodhimit 3.1: Shitjet e produkteve për mbrojtjen e bimëve	759,359/euro	≤ 759,359/euro	≤ 759,359/euro	1,197,126/euro.
2	Treguesi i prodhimit 3.2: Shitjet e antimikrobikëve veterinarë	379,704/euro	≤ 379,704/euro	≤ 379,704/euro	n/a
III.iii	Objektivi specifik 3.3 - Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cënueshme				
	Treguesi i ndikimit: tokave bujqësore në pronësi të grave	4.9%	10%	20%	n/a

IV.	Objektivi Strategjik 4 - Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime				
21	Treguesi i ndikimit 4.1: Niveli i transpozimit dhe zbatimit të legjislacionit përkatës të BE-së në nivel të MBPZHR-së	30%	50%	100%	75%
	Objektivi specifik 4.1 - Riorganizimi dhe funksionalizimi i plotë i AZHB-së si Agjenci IPARD				
	Treguesi i ndikimit 4.1: AZHB e ristrukturuar dhe funksionale sipas kërkesave të direktivave të BE-së. me staf të mjaftueshëm dhe të përgatitur si dhe pavarësi të plotë funksionale në përmbushjen e misionit të saj.	0	100%	100%	70 %, Ristrukturimi dhe funksionalizimi I vendeve te punës konform rregullores se re te nënshkruar, rekrutimi i 10 zyrtareve te rinj, rekrutimi edhe I 20 zyrtareve te tjerë te cilët priten te nënshkruajnë kontratat e aktemrimit me AZHB-ne, Themelimi i drejtorisë se financave ne AZHB, për pagesën e PD dhe PZHR.
	Treguesi i ndikimit 4.2: Procedura të brendshme të aprovuara dhe të zbatuara gjatë të gjitha fazave të zbatimit të PPD-së dhe PZHR-së.	0	100%	100%	80 % Përgatitja e doracakut te detajuar për implementimin e procedurave te pagesave direkte, fillimi i procedurave te akreditimit për IPARD
IV. i.	Objektivi specifik 4.3 - Arritja e besueshmërisë për menaxhim dhe zbatim të buxhetit për masat e programit IPARD III				
22	Treguesi i prodhimit 4:3 Niveli i arritjes së besimit të detyrave të zbatimit të buxhetit për 4 masa IPARD	0	50%	100%	0%,Nuk janë akredituar, ndërsa masat te cilat financohen nga buxheti nacional, kemi një nivel ne rritje te besueshmërisë, bazuar ne rritjen e numrit te aplikacioneve dhe ndarjen racionale te buxhetit.
V.	Objektivi specifik 4.2 - Digjitalizimi i sektorit dhe transferimi i njohurive dhe inovacionit				
23	Treguesi i ndikimit 5.1: Niveli i dixhitalizimit të MBPZHR, AZHB dhe institucioneve të tjera të koordinuara nga MBPZHR	40%	70%	100%	70% Është përmirësuar dukshëm Sistemi I menaxhimit te pagesave direkte, granteve, vlen te theksohet se aplikimi për PZHR realizohet ne sistem online për dallim prej viteve te tjera qe aplikimi është bere ne kopje fizike,
26	Treguesi i ndikimit 5.2: Niveli i ngritjes së Sistemit të Njohurive dhe Inovacionit Bujqësor (AKIS)	10%	50%	100%	50 % Është arritur një nivel i kënaqshëm i ngritjes se sistemeve te njohurive, dhe inovacionit, si ne sisteme ashtu edhe ne resurse humane.

*Nuk ka tregues specifikë, pasi objektivi horizontal është menduar të merret në konsideratë në nivelin e të gjithë treguesve të tjerë të mësipërm Modelet e ndikimit dhe treguesve të prodhimit duhet të ndjekin treguesit CAP të BE-së, siç janë paraqitur nga Komisioni Evropian https://agridata.ec.europa.eu/extensions/DataPortal/cmef_indicators.html

REFERENCAT:

- 1) MBPZHR/AM (2022): Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028;
- 2) Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023 -2027, vendimi i Qeverise se Republikës së Kosovës Nr.15/151, data 12 .07. 2023;
- 3) Ligji nr.08/l-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 8/ 29 mars 2023.
- 4) MBPZHR/AM (2023): Raporti i monitorimit të cilësisë së zbatimit të PBZHR 2023-27
- 5) MBPZHR/AM (2023): Raporti i monitorimit te SBZHR 2023-27
- 6) MBPZHR/AZHB (2024): Tabela permbledhjese e numrit te aplikacioneve, sipas masave dhe nemasave per PZHR 2024.
- 7) QEVERIA E KOSOVËS/ZKM (2021): PROGRAMI I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2021 – 2025;
- 8) BE/BB (2025) Progress Report as of: Improvement and Rehabilitation of Irrigation Systems Project (IRIS).
- 9) ASK (2025): Publikimt statistikore: 2023-2024.
- 10) MBPZHR (2025): Raporti i Punës së MBPZHR 2024;
- 11) MBPZHR/DAESB (2024) Raporti i gjelbër 2022, 2023 dhe 2024;
- 12) MBPZHR/Komsioni i ankesave (2024): ‘Raporti i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për projektet e zhvillimit rural 2023’;
- 13) BE/Berlin Economics GmbH (2024): Rishikim i shpenzimeve publike vlerëson shpenzimet e Kosovës për pagesat direkte në sektorin e bujqësisë
- 14) KE: Marrëveshja Sektoriale (MS);
- 15) Qeveria e Kosov’s (prill 2015) Marrëveshja Kornizë (MK);
- 16) MBPZHR/DI (2025): Analiza e zbatimit të planit të punës së MBPZHR-së për vitin 2024.
- 17) www.mbpzhr-ks.net
- 18) www.azhb-ks.net

